



Drejtoria për Shërbime Publike  
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge  
Department of Municipal Public Services

|                           |                                                      |
|---------------------------|------------------------------------------------------|
| Datë/Datum/Date:          | 07.07.2020                                           |
| Referenc-ë                |                                                      |
| Për/Za/To:                | Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit Komunal të Rahovecit |
| CC:                       | Anëtarët e Kuvendit Komunal                          |
| Përmes/Preko/Through:     |                                                      |
| Nga/Od/From:              | z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike    |
| Subjekti/Predmet/Subject: | Informatë                                            |



**Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit**

Komuna e Rahovecit ka planin 5 vjeçar të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike 2016-2021 i miratuar në dhjetor të vitit 2016 nga ekspert të fushave të drejtorisë së shërbimeve publike si dhe me ndihmën e ekspertëve të projektit DEMOS, ku edhe është mbështetur ky plan.

Komuna ka sipërfaqe prej 275,5 km<sup>2</sup>, me 35 vendbanime dhe një qendër urbane, ku në të gjithë territorin e komunës sonë, janë përfshirë hapësirat për mirëmbajtje.

Zonat e përfshirjes së HHP-ve në këtë dokument përfshin;

1. Mirëmbajtjen e gjelbërimit të ulët, të mesëm dhe të lartë,
2. Mirëmbajtjen e ambienteve të ndërtuara, sheshe, shtigje për këmbësorë dhe sipërfaqe të shtruara,
3. Mirëmbajtjen e hapësirave për parkim të automjeteve,
4. Mirëmbajtjen e ndriçimit publik në kuadër të HHP-ve, në kuadër të kësaj strategjie, mirëmbajtja e ndriçimit publik është kontratë e veçantë nga kontrata për mirëmbajtjen e hapësirave publike.
5. Mirëmbajtjen e varrezave, lapidarëve, pllakave përkujtimore, etj.

Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP-ve në qytetin e Rahovecit janë këto:

- Parqe gjelbërime, 6944 m<sup>2</sup>
- Sheshe, 865m<sup>2</sup>
- Shëtitore pranë lumit, 3100 m<sup>2</sup>

**KOMUNA RAHOVEC**

- HHP-të pranë lapidareve, 44 m2
- HHP-të pranë pllakave përkujtimore, 4552 m2
- Varreza të dëshmoreve, 7528 m2
- Varreza të martireve, 4750m2
- Varreza në zonën urbane, 99921.5 m2
- Varreza në zonën rurale, 147997 m2

Ne, duke respektuar rekomandimet dhe planin e aprovuar, si Komunë e Rahovecit kemi kontraktuar tre operator ekonomik që kanë kontratë me Komunën e Rahovecit për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

- Lot 1- 27,187.28 euro, në 40 lokacione është paraparë mirëmbajtja,
- Lot 2- 21,799.46 euro, në 37 lokacione,
- Lot 3 -19,726.92 euro, në 26 lokacione,
- Gjithsej 103 lokacione, duke përfshirë, varreza të dëshmorëve, lapidarëve, pllakave përkujtimore, sheshe, trotuare, rreth-rrotullime, hapësira të lira publike, etj...

Vlera e tyre në total për tre operatorë ekonomik sillet në **68,713.66** euro, derisa në vitin 2019 vlera në total për mirëmbajtje ka qenë **53,302.16** euro, kjo rritje është për shkak të krijimit të hapësirave të reja gjelbëruese që po bëhen çdo vit.

#### **Synimet dhe objektivat specifike**

Në kuadër të HHP-ve një ndër synimet kryesore është edhe ngritja e nivelit të mirëmbajtjes dhe përmirësimi i cilësisë, nëpërmjet planit të hartuar, si:

- Sensibilizimi i komunitetit për mirëmbajtjen e hapësirave publike, si dhe
- Rigjallërimi i HHP-ve, duke rritur sipërfaqet publike me parqe, drunj dekorativ, hapësira të gjelbëruara, investime në zonat e ndotura, rikthimi i atyre deponive ilegale në hapësira të gjelbëruara, mbjellja e drunjve dekorativ në rrugët kryesore dhe atyre lokale.

Tashmë kemi një rritje enorme nga viti në vit në kuadër të mirëmbajtjes së hapësirave publike, përveç investimit kemi rritje edhe në kosto financiare të mirëmbajtjes.

Me respekt,

**Përparim Krasniqi**

Drejtor i Shërbimeve Publike

#### **KOMUNA RAHOVEC**

---

Drejtoria për Shërbime Publike  
Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë  
Tel: +383 29 276 943  
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>



# Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



## Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam Department of Economy, Development and Tourism

|                         |                                                             |
|-------------------------|-------------------------------------------------------------|
| DATE /A:                | 08.07.2020                                                  |
| PËR/ZA/TO :             | Z. Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit  |
| NGA/OD/FROM:            | Z. Artan Asllani, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm |
| LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Informatë për Kuvend                                        |

REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLICA OF KOSOVO  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

### I nderuar!

-III- Nr. l prot. 2223 Më 08.07.2020  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Kuvendi komunal i Rahovecit në vitin 2001, konkretisht delegatët kanë nxjerrë vendim për themelimin e zonës ekonomike – parkut industrial në fshatin Opterushë (vendimi 01 nr.65 i datës:13.07.2001), pastaj në vitin 2004 Kuvendi komunal merr vendim mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit mbi caktimin e zonës ekonomike-parkut industrial (vendimi 01nr.112 i datës 30.03.2004), me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi mbi caktimin e zonës ekonomike-parkut industrial 01 nr.65 i datës 13.07.2001 në nenin 1, me që rastë zonës ekonomike – parkut industrial në parcelën nr.346 z.k.Opterushë i zvogëlohet sipërfaqja për 1.00.00/ha pra nga 35.89.84/ha në 34.89.83/ha. Sipërfaqja prej 1.00.00 ha është destinuar për ndërtimin e fushës futbollistike në Opterushë dhe i'u është dhënë në menaxhim Drejtorisë për Kulturë,Rini dhe Sport. Komuna e Rahovecit vazhdimisht ka dërguar kërkesa në Qeverinë e Rep. së Kosovës për themelimin e zonës ekonomike-parkut industrial, por tek në vitin 2018 me vendim të Kryeministrit z.Ramush Haradinaj (vendimi nr.03/52 ,datë:22.06.2018) aprovet kërkesa e K.K.Rahovecit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme "pasuri shtetërore e Kosovës ,K.K.Rahovec, shfrytëzuese Ekonomia Pyjore me nr të njesisë kadatsrale P-71510056-00346-0 për krijimin e zonës ekonomike-parkut industrial në fshatin opterushë.

Pas marrjes së vendimit nga Qeveria e Rep. së Kosovës për themelimin e zon.ekonomike-park.industrial K.K.Rahovec konkretisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-159 PËR ZONAT EKONOMIKE, UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MTI) NR. 01/2014 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË PARAQITJES SË KERKESËS PËR MARRJEN E PËLQIMIT, PROCEDIMIT TË SAJ DHE DHËNIEN E PËLQIMIT, MËNYRËN DHE PROCEDURAT PËR KONSULTIM PUBLIK, SI DHE PËRMBAJTJA E RIGJISTRIT TË ZONAVE EKONOMIKE dhe UDHËZIM ADMINISTRATIV (MTI) Nr. 02/2014 PËR PËRMBAJTJEN E STUDIMIT TË FIZIBILITETIT ka parashtruar kërkesa për paisjen me pëlqime nga Ministritë e linjës dhe institucionet tjera për licencim të zonës ekonomike-parkut industrial (Ministria e Bujqësisë,Pulltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minierale-KPMM-ja, Instituti arkeologjik i Kosovës – MKRS, Studimin e fizibilitetit , Pëlqimin elektro-energjetik nga KEDS-i, gjithashtu kemi organizuar debatin publik me banorët e fshatit Opterushë dhe fshatërave për rreth.

**Projektet e hartuara për licencim të zonës-ekonomike-parkut industrial:**

- Projekti Ideor i Zonës Ekonomike-Parkut industrial
- Projekti për trajtimin e ujërave të zeza
- Projekti për furnizim me ujë
- Plani Zhvillimor komunal
- Projekti për furnizim me energji elektrike-zgjidhje teknike, si dhe dokumentet plotësuese të kërkuara nga Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë -MTI-ja

-Pas kompletimit të të gjitha dokumenteve, pëlqimeve dhe projekteve, K.K.Rahovec e ka parashtruar kërkesën për licencim të Zonës Ekonomike-Parkut industrial në Ministrin për Tregëti dhe Industri, kërkesa me nr. 235 të datës 22.01.2020, pas shqyrtimit të lëndës dhe kërkesës nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë ( KIESA ), Ministri i Tregëtisë dhe Industrisë Z.Endrit Shala me Vendimin 01.Nr.Prot.410 të datës: 27.01.2020 jep Pëlqimin për themelimin e Zonës Ekonomike, respektivisht Parkut Industrial në fshatin Opterushë.

-Pas themelimit dhe licencimit të zonës ekonomike-parkut industrial K.K.Rahovecit ka parashtruar kërkesë në Ministrin për Tregëti dhe Industri-MTI për mbështetje financiare për funksionalizimin e zonës ekonomike-parkut industrial por që nuk është miratur deri më tani. Komuna e Rahovecit në vitin 2018 ka investuar në rrafshimin dhe nivelizimin e një pjesë të zonës ekonomike në vlerë prej 4,360.00 € , ndërsa në vitin 2019 komuna e Rahovecit ka investuar në vlerë prej 68,460.00 €, investimet janë kryer në rrafshimin dhe rrethimin e një pjesë të zonës ekonomike - parkut industrial. Gjatë vitit 2020 do të hartohet projekti kryesor për zonën ekonomike-parkut industrial,për vitin 2020 presim mbështetjen financiare nga Qeveria e Rep. së Kosovës dhe Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë.

**Me respekt!**





## Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

### *Kuvendi i Komunës Rahovec*

*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.06.2020**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm.

Para se me fillua punimet për mbledhjen e radhës, fjalën ja kisha dhënë Kryetarit të Komunës z. Smajl Latifi për shkak se do të ketë një udhëtim.

**Kryetari** – Përshëndetje për Kryesuesin e Kuvendit z. Afrim Dina, anëtarët e kuvendit të Komunës, drejtorë të drejtorive dhe gjithë ata që po e përcjellin këtë seancë të rregullt të Kuvendit të Komunës. Unë besoj që edhe në emër tuajin por edhe në emër të qytetarëve të komunës dëshiroj të shprehë papajtueshmërinë, kundërshtimin dhe indignatën për propozim aktakuzat e ngritura nga prokurori i dhomave të specializuara të Gjykatës Speciale në Hagë kundër Presidentit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaqi dhe kundër ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës z. Kadri Veseli si dhe të tjerëve që ende nuk dihet që së paku zyrtarisht se kush janë. Besoj që është e arsyeshme që të shprehim ndjenjat tona njerëzore si qytetarë të Komunës së Rahovecit pasi komuna jonë ka pasur humbje të mëdha dhe ka përjetuar tragjedi të mëdha ku ka humbur shume njerëz në luftën e fundit ku aparati shtetëror në mënyrë të organizuar i pushtuesit serb ka kryer krime çnjerëzore kundër qytetarëve tanë të paarmatosur e të pambrojtur vetëm pse kanë qenë shqiptarë. Janë dhjetë masakra në komunën e Rahovecit të cilat janë kryer në periudhën 98-99 të shekullit të kaluar, janë 64 të zhdukur vetëm nga Krusha e Madhe përfshirë edhe profesorin e nderuar Ukshin Hoti. Në këto masakra janë vrarë e keqtrajtuar, masakruar e janë djegur e zhdukur gra, pleq, burra e fëmijë. Gjykata speciale është gjykatë një etnike dhe si e tillë është e padrejtë dhe e papranueshme ngase pretendon të zbardhë të ashtuquajturat krimet e pretenduara siç thuhet të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lufta për Liri e popullit tonë ka qenë luftë që ka dëshmuar se ka vlera të veçanta, vlera historike dhe njerëzore, qytetare, kulturore edhe të trashëgimisë dhe këtë luftë që ju imponua popullit shqiptar që të zgjedh mjetet e duhura në kohën e duhur, e kanë përkrahur dhe mbështetur edhe forcat ajrore të NATO-s në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe si e tillë mbetet dhe vazhdon e sigurisht që do të mbetet përjetësisht edhe në kujtesën tonë edhe në histori pra edhe në kujtesën e brezave që do të vijnë pas nesh luftë e drejtë, e luftë për liri, luftë mbrojtëse, pra luftë që dëshmon vlerat e drejtësisë humanizmit pastërtisë dhe vlerat e një lufte e cila ka përfaqësuar të drejtat e një populli i cili ka qenë i shtypur i robëruar e i keqtrajtuar i persekutuar nga shteti serb. Unë personalisht edhe si Kryetar Komune jam kundër aktakuzave të cilat i cilësojmë që janë të padrejta dhe kundër çfarëdo tendence që tenton me vendosur baraspeshe midis luftës së popullit tonë që ishte luftë e drejtë për liri e mbrojtëse e çlirimtare dhe luftës së Serbisë e cila ka pasur vetëm një qëllim të mbajë të pushtuar këtë popull, të përdor skenarë dhe plane antishqiptare madje duke përfshirë edhe skenarë të shfarosjes edhe dëbimin e dhunshëm të popullsisë. Duke qenë se jemi në një trevë që ka humbur shumë mbi 1000 të vrarë e të masakruar, duke qenë se jemi nga një trevë e cila ka përjetuar tragjedi e dhimbje pafund, duke qenë se jemi nga një trevë që ka ende plagë të hapura dhe ende të pagjetur, natyrisht unë shpreh bindjen time edhe shpresoj të shumicës dërmuese të

qytetareve të komunës së Rahovecit se tendenca për ta njollosur luftën çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përveç se është e padrejtë, është diskriminuese e po ashtu edhe në kundërshtim me vlerat demokratike e paqedashëse dhe me vlerat më të mira që ka populli ynë dhe popujt liridashës të botës demokratike. Shpreh kundërshtimin kundër propozim aktakuzës ndaj z. Thaqi dhe z. Veseli dhe të tjerëve duke qenë të bindur jo vetëm me pafajësinë e ish eprorëve e ish udhëheqësve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke qenë të bindur se nuk munden të gjinden askund pjesëtarë të UÇK-së që kanë kryer krime kundër popullatës civile, kundër popullatës së paarmatosur ashtu siç kanë kryer krime që bota i din dhe i ka gjykuar, e ato janë krimet serbe të cilat ishin krime lufte, krime ndaj njerëzimit, torturë, vrasje, keqtrajtime, burgosje, dëbim me dhunë e madje edhe plane për shfarosje. Pra Serbia është agresori ndërsa ne jemi ata që jemi mbrojtë nga agresori serb. Rroftë lufta e popullit tonë për liri e i përjetshëm kujtimi për Dëshmorët e Martirët e kësaj lufte kurse aktakuzat e tilla vetëm se do të na forcojnë edhe unë kërkoj që ta kemi parasysh faktin se sa i nevojshëm e jetik dhe i domosdoshëm është uniteti brenda nesh në mënyrë që të kundërvihemi tendencave armiqësore që kanë për qëllim ta njollosin luftën tonë. Faleminderit shumë

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë kryetar për shprehjen e shqetësimit që po na bëhet, dhe ftesave ndaj luftëtarëve dhe ushtarëve tanë.

Të nderuar kuvendarë, për këtë mbledhje sot propozojmë këtë :

### **REND DITE**

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,**
- 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2021-2023,**
- 4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – rregullores për taksa komunale,**
- 5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për faljen e borgjit për taksë komunale.**

Të nderuar kolegë kuvendarë, a jeni për këtë rend dite. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

A ka dikush diçka rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar dhe nëse jo atëherë e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës :

**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve .**

**Masar Popaj** – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtor të drejtorive, delegate dhe ju gjithë të pranishëm. Pyetja ime ka të bëjë me rrugën Fortesë-Celinë dhe këtë pyetje i drejtohem drejtorisë përkatëse dhe njëherësh desha të uroj për punën që po kryhet në terrene në riparimin e rrugëve të asfaltuara si në qytete ashtu edhe në fshatra. Por e shoh më se të nevojshme rrugën Fortesë Celinë pasi që kjo rrugë është më e dëmtuara në krahasim me këto rrugët tjera që po riparohen. Këtë mund ta dëshmojnë edhe kolegët e mi delegatë si Kryesuesi Afrim Dina, Faton Ramadani, Rasim Fazliu pastaj drejtori Rumir Zhuniqi dhe të tjerët. Kjo rrugë

më së shumti është e dëmtuar sidomos në fshatin Fortesë në lagjen e Zhuniqëve, kështu që pres një përgjigje nga ju se kur do të bëhet riparimi i kësaj rruge. Faleminderit

**Sali Sallteku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pasi kolegu i përmendi rrugët atëherë edhe unë po shkoj te rruga kryesore. Vërtet është e mundimshme me ardh në Rahovec pasi firma e cila është duke punuar ne segmentin prej në dalje nga Fortesa e deri te Stone Castle është e mundimshme me kalua andej. E pakuptueshme se si punohet aty dhe krejt në mënyrë të panevojshme e kanë prishë rrugën ashtu. Kryetari na kishte thënë se është një firmë e mire dhe serioze mirëpo nga ajo që po shihet del e kundërta pasi vërtet është firmë e dobët. Nuk e di vërtet si qëndron puna rreth kësaj mirëpo e shoh që pjesa tjetër e segmentit ku punohet nga kompania Euroasfalt duket se po punohet mirë dhe me intensitet, kurse në atë pjesën andej vërtet e tmerrshme si punohet në atë mënyrë. Po ashtu unë desha me bo një kërkesë pasi në emër të fshatit veç e kam bërë në mbledhjen e kaluar edhe përgjigja e nënkryetarit ishte se nuk kanë kërkuar participim nga komuna. Mirëpo unë e di se çdo kërkesë që bëhet për diçka, sigurisht edhe komuna participon me një shumë të caktuar dhe ne si fshat i kemi grumbulluar mbi 50,000 euro për rregullimin e asaj odës së fshatit. Unë nuk po kërkoj që komuna të participoj 80% kurse ne si komunitet me 20% por e kundërta 80% e paguajmë ne si fshat kurse komuna të merr pjesë me 20% dhe sigurisht që Kryetari duhet ta ketë parasysh këtë dhe sigurisht e mirëpresim edhe ndihmën e komunës pasi është vullnet i qytetareve aty, pasi kanë mbledhur 40,000 euro dhe tash nuk kanë mundësi edhe me krye këtë kështu që komuna duhet me marr pjesë me shumë të caktuar, pasi një bashkësi lokale që i qet 80% të mjeteve atëherë 20% duhet të jetë pjesëmarrës komuna, edhe konsideroj që duhet të dërgohet kjo porosi në vendin e duhur dhe sigurisht që pres edhe një përgjigje rreth kësaj. Faleminderit!

**Hanalora Hoti** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë desha të ja bëj një pyetje drejtorit të Bujqësisë se a ka filluar përgatitja për hapje të thirrjes për pagesa direkte ose subvencione, kur do të filloj puna me orar të rregullt dhe a kanë me qenë të hapura sërish zyrat në disa fshatra përkatësisht në Ratkoc dhe Krushë të Madhe për pritjen e fermerëve. Faleminderit!

**Besa Bytyqi** – Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë, unë kam dy pyetje drejtuar drejtorit të Shërbimeve Publike por si duket Përparimi nuk qenka prezent. Uji në Opterushë është një problematikë që është tejet shqetësuese për banorët e asaj ane dhe e kemi burimin tonë që menaxhohet prej KRU Gjakova mirëpo uji nuk është 100% i pijshëm pra është një problem që po i shqetëson tash e sa vite banorët e asaj ane duke përfshirë edhe Zoqishtin edhe fshatrat përreth. Unë kërkoj nga Kryetari i Komunës pastaj nga Drejtori i Shërbimeve Publike që në bashkëpunim me KRU Gjakova të gjejnë një zgjidhje sa më të shpejtë për këtë problematikë. Ndërsa pyetja tjetër është gjithashtu për drejtorin e Shërbimeve Publike e saktësisht për kompaninë e mirëmbajtjes se hapësirave të gjelbëruara. Tash e sa kohë ata nuk po i përmbahen kontratës pasi ne e dimë që në momentin që e nënshkruajnë kontratën atëherë dalin obligime kontraktuale për të dyja palët ndërsa kompania nuk po e bën një gjë të tillë, që do të thotë se kompania e bën punën ashtu pa kontroll edhe paguhet me taksat dhe paratë e qytetareve tanë. Kërkoj që të bisedohet seriozisht me kompaninë dhe jo të mbetet bari ashtu siç e kanë hequr pa e mbledhur dhe pa e ujitur. Faleminderit!

**Ali Zhuniqi** – Përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë kolegët në sallë. Në lidhje me çështjen e rrugës Fortesë- Celinë, kjo ishte kërkesë edhe para një viti dhe nuk është marr asgjë në këtë drejtim pra është për keqardhje sidomos për banorët aty. Por une kam edhe një kërkesë tjetër në lidhje me ndërtimin e rrugës që është duke u bërë katër korsi Rahovec-Xërxe. Gjate kohës kur e vijoj e shoh se ka mungesë të sinjalizimit për njoftimin e qytetarëve të cilët e përshkojnë këtë rrugë që po besoj edhe ju vet keni mundësi me pa e sidomos natën, që ka një mungesë të profesionalizmit të drejtimit sa i përket sinjalizuesve për me i njoftua qytetarët

pasi duhet me marr seriozisht sepse paraqet rrezik edhe tash një ndeshje në komunikacion e dimë se cilat janë rreziqet, kështu që kisha kërkuar të bëni një kërkesë për sinjalizime.

**Trajko Shariq - .....**

**Rukije Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit në sallë. Unë e kam si kërkesë nga fermerët të cilët kanë fituar serra edhe kanë kërkuar që a ka mundësi që me zbrit 20% edhe me bo në 10% të përfitimit të serrave të pagesave të tyre. Edhe pyetja e dytë ishte përgjatë rrugës Vrajak – Bratotin –Ratkoc pranë një përroskë kundërmon një erë e keqe dhe e padurueshme për banoret e asaj lagje, pasi aty derdhet kanalizimi i fshatit Vrajak dhe kjo është e papërballueshme për banoret e lagjes për shkak të erës që kundërmon aty dhe kjo është mjaft shqetësuese edhe për kalimtarët aty por edhe banorët që jetojnë aty përreth. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë e nderuara Krasniqi, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, pyetjet që janë bërë nga kuvendarët, ndoshta nënkryetari apo drejtorët që janë prezent dhe që ju kanë drejtuar me pyetje.

**Fehmi Hoxha** – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, kolegë kuvendarë, drejtorë të ekzekutivit dhe gjithë të pranishmit në sallë. E di që këto që do të themi nuk janë ne rend të ditës mirëpo paraprkishtë para se me hy në temë. Unë propozoj që shefat e grupeve të mblidhen për një pauzë të shkurtër dhe të dalim me një deklaratë për supozim ose ngritjen e aktakuzave ndaj çlirimtareve edhe ne si Kuvend të miratojmë një deklaratë. Pra do të ishte mirë për një pauzë të shkurtër, të mblidhen shefat e grupeve dhe dikush nga ata të lexoj deklaratën. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Hoxha, personalisht pajtohem me propozimin tuaj, mirëpo para se me marr pauzën atëherë po vazhdojmë me përgjigjet të cilat i ka nënkryetari për pyetjet që janë ngritë prej kuvendareve dhe drejtorët për ata që janë prezentë këtu mund të japin përgjigje. Pasi të përfundon përgjigjet nënkryetari atëherë shefat e grupeve mblidhen ne zyrën e kryesuesit. Faleminderit!

**Fatmir Iska** – Faleminderit i nderuar Kryesues, te nderuar anëtarë të Kuvendit dhe përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Unë do të mundohem të jap përgjigje për ato që jam në dijeni, drejtorët mund të japin përgjigjet e tyre dhe po ashtu është e drejtë edhe me shkrim të japin përgjigjet në mungesë të drejtorëve që nuk janë prezentë. Pyetja nga Masar Popaj për rrugën Fortesë - Celinë a do të bëhet riparimi? Ne kontratën e kemi dhe është aktive mirëpo buxhet nuk ka por duhet të lutim operatorin pastaj do të shohim në rishikim apo ridestininim dhe shpresojmë që kjo të shtrohet me një shtresë të asfaltit. Meqenëse e kemi kontratën, po besoj që e kemi me lehtë e pastaj për buxhet do të mundohemi me gjete mjete shtesë për këtë rrugë, pasi edhe unë po kaloj andej e jo veç ata që përmendet ju dhe gjithë ne kalojmë atypari dhe vërtet është e dëmtuar dhe jo në gjendjen e mirë ajo rrugë, njëkohësisht përgjigja është edhe për Ali Zhuniqin për këtë rrugë. Pastaj z. Sali Sallteku ka bërë pyetje për rrugën katër korsi prej Fortesës e deri në Stone Castle. Edhe unë kam vërejtjet e mia për këtë rrugë pasi aty krijohet pluhur i madh, mungese e sinjalistikës dhe të gjitha këto qëndrojnë. Ne si komunë e kemi dhënë maksimumin tonë rreth angazhimit për këtë por sigurisht që do të përdorim edhe elementet represive ndaj operatorit i cili punon aty dhe e ka për obligim pasi ka lidhë një kontratë pra është i obliguar për atë punë. Do të bisedojmë edhe me drejtorin e shërbimeve publike edhe me menaxherin Sylejman Daka që njëkohësisht të mbikëqyrret kjo punë pasi vërtet është ashtu siç e keni parashtruar pyetjen tuaj. Ndërsa tek pyetja e dytë oda e fshatit, në këtë pyetje ju kam përgjigjur edhe në seancën e kaluar në mbledhje të KPF-së, se kërkesa e fshatit ka qenë ju do ta ndërtoni atë shtëpi me vetëfinancim pasi ashtu është bërë kërkesa nga kryetari i fshatit. Por, unë them që ju duhet t'i drejtoheni kryetarit të Komunës me një kërkesë, të kërkon mbështetje apo participim për ndërtimin e asaj ode por unë do të përmendi vetëm dy prej këtyre odave apo shtëpive të fshatit që i kanë bërë me mjete vetanake. Pra në Drenoc lagja e Berishëve e ka të ndërtuar me

vetëfinansim dhe në Senoc që kalon skaj rrugës dhe ne i kemi ndihmuar atyre në rregullimin e një pjese të oborrit në Senoc. Por, kjo nuk do të thotë që ne nuk e ndihmojmë, ndoshta me 20% te mjeteve nuk lidhim marrëveshje ose një memorandum për bashkëfinansim por asistojmë në ndihmë tjetër qoftë të rrugës apo edhe diçka tjetër. Pyetja nga Hanalora Hoti rreth thirrje për aplikim për subvencione. Ministria e Bujqësisë ka ndërmarrë disa hapa dhe ne po presim që ajo thirrje të vijë tek ne dhe të filloj aplikimi për subvencione. Ne jemi të gatshëm ashtu siç kemi vepruar edhe vitin e kaluar do të jenë përsëri 3 qendra të aplikimit, pra është këtu në Komunë pastaj në Krushë të Madhe dhe ne Ratkoc. Të gjitha përgatitjet janë në rregull dhe në momentin se bëhet thirrja, ne do të fillojmë me punë.

Besë Bytyqi për ujin në Optrushë edhe kompania për hapësira publike. Ju e keni më se afërmi drejtorin e Shërbimeve Publike dhe sigurisht që ju jep një përgjigje adekuate për këtë. Tek kompania për hapësira publike ata i kanë të kontraktuar se çka kanë me krye pasi të gjitha janë të definuar në kontratë mirëpo ne mundemi me kërkua edhe ajo qëndron pasi ka shume rrugë pothuajse ne çdo vendbanim ku ka barishte të mëdha janë të pa pastruara si dhe për ujin me sa e di unë Optrusha furnizohet prej burimit pasi e ka burimin e vet. Ne do të bisedojmë edhe me KRU Gjakova se çka mund të bëhet për kyçe nga Retija por prapë do të bisedoj me drejtorin e Shërbimeve Publike për këto dy pyetje që ju i parashtuat. Tani nuk mundem me ju dhanë përgjigje të sakta përderisa nuk i kemi edhe atë. Tek asamblisti Ali Zhuniqi kishim dy pyetje edhe u përgjigja edhe në pyetjet e Masarit. Pastaj Trajko Shariq rreth zjarrit në shtëpinë në Lagjen e Epërme, sipas informatave që ne kemi zjarri ka qenë i natyrshëm, nga diçka brenda që është krijuar por sidoqoftë kjo ju takon organeve dhe kompetencë e policisë pasi është lajmëruar rasti por edhe komisionet përkatëse të AME-s të zjarrfikësve këtu që bëjnë raporte edhe pastaj do të shohim rreth kësaj. Tash për momentin mundemi veç me paragjykua se çka, pasi nuk ka motive tjetër përpos zjarrit natyral që ka ndodhur natyrshëm që ndodh edhe ne shtëpitë tjera. Pra të mos i japim etiketim që kjo shtëpi është e serbit, shqiptarit apo komunitetit RAE, por është një shtëpi që ka ndodhur zjarri fatkeqësisht. Tek assembleistja Rukije Krasniqi rreth zbritjes se participimit për serra nga 20% ne 10% që me herët ka qenë 75% me 25% pastaj ne e kemi zbritur nga 80% ne 20% dhe thirrja ka qenë dhe është nënshkruar kontrata dhe ka marr fund d.m.th. nuk mundet me u zbrit.

**Kryesuesi** - Faleminderit shumë nënkryetar, meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore ( KAB ) 2021 – 2023.**

**Afrim Limani** – I nderuar kryesues, nënkryetar, asamblistë dhe gjithë ju të pranishëm. Me datë 15.05.2020 në adresë të Komunës së Rahovecit ka arrite qarkorja e parë buxhetore, ku janë përcaktuar limitet apo tavanet buxhetore për komunën e Rahovecit për vitin 2021, si dhe projeksionet për vitin 2021,2022 dhe 2023.

Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2021 në total është prej 14,548,823 euro, që ka një ndryshim negativ apo me i vogël në raport me vitin 2020 në shumën prej 186,996 euro. Pra granti i përgjithshëm është 186,996 euro si rezultat i zvogëlimit të grantit të përgjithshëm dhe grantit të arsimit. Granti i Arsimit është i zvogëluar në shumën prej 75,214 euro ndërsa granti i përgjithshëm 173,251 euro. Ndërsa ka një rritje simbolike të grantit të shëndetësisë në vlerë prej 61,345 euro dhe në total ndryshimi është negativ apo me i vogël në krahasim me vitin aktual që jemi në vitin 2020. Shtrohet pyetja se pse është zvogëlim i buxhetit, që sipas eksperteve të cilët merren me analiza financiare dhe projeksione në vitet në vazhdim, do të thotë pasojat e Covidit do të i bartim edhe në vitin 2021 do të thotë kjo është arsyeimi sipas tyre. Ne si drejtori e Financave KAB-in komunal e kemi përgatitë si dokument, ku pjesa teorike që është objektiva dhe sqarimet ndërsa ka mungesa të theksuara që pa ardh qarkorja e dytë buxhetore ne nuk mundemi me ditë saktë sa do të i kemi edhe kategoritë ekonomike pra pozicioni i pagave, mallrave, investime kapitale. Mirëpo ne si drejtori i kemi bërë

analizat tona dhe ato përafërsisht kanë me qenë të njëjta që tash do të shohim edhe në monitor përmes disa sllajdeve që i kemi pergaditë. Për me kuptue ju me mirë edhe me thjeshtësua, unë kam menduar edhe përmes slajdeve me paraqit KAB-in komunal.

Ashtu siç e shpjegova me herët, buxheti total është prej 14,548,823 euro, granti ka një zvogëlim prej 186,000 euro, në tabelë janë edhe projeksionet për vitin 2021-2023. Ne faqen e dytë kemi një grafikun në formë sferë ku është i paraqitur buxheti në total bashke me grante të arsimit, të shëndetësisë dhe grantin e përgjithshëm të administratës, gjithashtu është edhe Këshilli i fshatit Hoxhë që ka një rritje simbolike prej mbi 100 euro. Tash data 30.06.2020 konsideroj se është data e fundit që e përcakton edhe buxhetin tonë me kategori ekonomike që janë të varura, pozicioni i pagave dhe investimet kapitale. Nëse zbatohet ligji atëherë njëra rritet kurse tjetra zvogëlohet por më mirë shihet edhe në këtë tabelarë. Në bazë të analizave tona përafërsisht si drejtori e Financave, buxheti në kategori ekonomike do të jetë kështu, por me se miri është qarkorja e dytë buxhetore e cila i cakton limitet edhe tavanet buxhetore. Pozicioni i pagave dhe mëditjeve nëse nuk zbatohet ligji i pagave që sipas kushtetutës është data e fundit 30 Qershor, atëherë pozicioni i pagave do të jetë 7,619,177 euro, ndërsa investimet kapitale do të jenë me vlerë prej 4,562,669 euro, do të thotë këtu është ndryshimi pra totali i buxhetit prej 14,548,823 euro e ato janë përafërsisht projeksionet për vitin 2022/23. Të hyrat vetanake kanë qenë të njëjta po nga viti 2022, zakonisht para se me u zbatua qarkorja e dytë buxhetore, të gjithë drejtorët e buxhetit në nivel komunës i thirrën për konsultime dhe kërkesa të ndryshme. Ne si drejtori kemi menduar se do të kërkojmë se investimet kapitale të rriten të paktën prej 10,000 euro, e kemi shembullin me te mirë pasi të njëjtën kërkesë e kam bërë edhe vitin e kaluar, edhe pse nuk e kanë shqyrtua kërkesën tonë rezultatet në fund të vitit 2019 kanë dalë të sakta ashtu siç kemi kërkuar. Besoj që kësaj here kërkesa jone do të aprovohet me rritje të hyrave vetanake me një vlerë përafërsisht 100,000 euro, atëherë kuptohet edhe buxheti do të rritet në total bashke me grantin e përgjithshëm. Tash në rastin konkret e kemi nëse zbatohet ligji i pagave atëherë pozicioni i pagave do të jetë me vlerë prej 9,112,207 euro kuptohet në dëme të investimeve kapitale pra investimet kapitale do të jenë 3,250,786 euro, ku përafërsisht mbi 1 milion euro do të shkojnë në pozicionin e pagave. Pra këtu është krejt esenca që varet te ligji i pagave që a do të zbatohet apo jo atëherë ka edhe lëvizshmëri edhe buxheti jonë, e sigurisht edhe e dimë saktë sa do të jenë pozicioni i pagave dhe investimet kapitale.

**Sali Sallteku** – Kur ke pyetja te ligji i pagave, atëherë si duket paratë po merren prej grandeve edhe sa do të jenë me pak pastaj grandet nuk e kuptova, pra këtë po kërkoj ta di.

**Afrim Limani** – Krejt kjo do të varet nga ligji i pagave do të thotë data 30 qershor, nëse aprovohet ligji i pagave, e thash edhe në fillim në bazë të analizave tona si drejtori e Financave se më se miri këto përcaktohen në qarkoren e dytë buxhetore, por përafërsisht do të mbetet kështu. Atëherë pozicioni i pagave do të jetë në total 9,112,207 euro pra rritja do të jetë mbi 1 milion .

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje kryesues, nënkryetarin, anëtarët e Kuvendit Komunal, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave, të OSBE-së, LMT-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. E falënderoj drejtorin për prezantimin e KAB-it për vitin 2021-2023. Unë desha t'i ngrisë disa çështje rreth KAB-it, drejtori i ka paraqitur disa objektiva edhe unë desha të cek se çfarë objektiva kanë paraparë për menaxhimin e ujërave të zeza gjerësisht që moti keni përmend ndërtimin e një kolektori që në bazë të terrenit ndoshta edhe të dy kolektorëve për mbledhjen e ujërave të zeza dhe dërgimin në një impianti që sigurisht që jam i vetëdijshëm se nuk bëhet me mjete vetanake ose me buxhete të Komunës, por Komuna duhet me pas edhe objektiva me kërkuar mjete edhe diku tjetër edhe me i arrit këto qëllime. 1. A janë të paraparë këto objektiva? dhe 2. Rreth menaxhimit të mbeturinave, në qysh moti kemi pasur këtë çështje të ngritur edhe kemi thënë se nëse Komuna

do të kishte mundësi të merret me menaxhimin e mbeturinave edhe të hyrat komunale do të rriteshin, kështu që edhe në këtë drejtim rreth menaxhimit të mbeturinave në këtë KAB-ë a është parashikuar diçka? Këto ishin pyetje konkrete rreth kësaj çështje. Tash do të ndalem tek faqe 3, ku thuhet se në Komunën e Rahovecit operojnë mbi 3684 biznese ndërsa në faqe 9 tek tabela 1 ku është indikatorët ekonomik komunal cekët se numri i bizneseve të regjistruara në vitin 2020 është 2450. Desha me ditë këtu se për çka bëhet fjalë se pse është ky ndryshim i shifrave sepse dallimi nuk është bash i vogël afërsisht 1234 biznese. Kërkoj sqarime prej drejtorëve në përgjithësi. A nuk janë aktive ato biznese në këtë ndryshim apo duhet me përmirësuar këto shifra ju edhe KAB-i me qenë ashtu si duhet. Faleminderit!

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorët që janë prezent në sallë, po ashtu e falënderoj edhe drejtorin për Financa për prezantimin e draftit të parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore për komunën tonë 2021 – 2023. Në materialin që kemi marr ne kuvendarët, buxheti është i prezantuar blanko edhe granti qeveritar edhe planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2021, ndërkaq atë që e prezantoj me sllajde se është përgatitur edhe pjesa në bazë të kategorive buxhetore. Ne nuk e kemi pasur në material edhe pse në qarkoren buxhetore të parë e kemi vërejtur se aty thuhet decidivisht që Komuna duhet të përgatisë kornizën afatmesme buxhetore 2021-2023 deri më 30 qershor edhe të kaloj në Kuvend por në bazë të kategorive buxhetore, ne shumat nuk i kemi pasur por tash i vërejtëm. Mirë është që është planifikuar sikur nuk do të ketë zbatim të ligjit të pagave por njëkohësisht edhe pjesa tjetër, ajo që është nëse zbatohet ligji i pagave. Ne kemi vërejt se ka një buxhet me pak sa i përket grantit qeveritar që është ndarë nëpër komuna e tha edhe drejtori dhe për komunën tonë është diku 187,000 euro më pak dhe është paraparë që në grantin e shëndetësisë të ketë një rritje të lehtë ndërsa në grantin e përgjithshëm dhe të arsimit të ketë më pak buxhet. Sidoqoftë në të ardhmen, unë besoj që komuna do të planifikoj pjesën e shpenzimeve buxhetore në hollësi ku do të diskutojmë hollësisht në mbledhjet e ardhshme ndërsa tani isha ndal të pjesa e të hyrave vetanake që është shuma e njëjtë që është paraparë sikurse vitin e kaluar 1,156,841 euro nuk ka ndonjë ndryshim. Unë mendoj që kur të planifikohet hollësisht të hyrat, mendoj që komuna duhet të parasheh më tepër të hyra se sa kjo shumë e vitit të kaluar, duke u nisur edhe nga fakti se ne e kemi pasur në vitin 2019 të hyrat më tepër dhe hiq me larg në mbledhjen e kaluar të kuvendit komunal e kemi aprovuar një kërkesë nga drejtori i shëndetësisë një shumë të hyrave prej 140,000 që ka qenë tejkalim i buxhetit. Pra poenta është që Komuna të parasheh me tepër, nuk do të thotë që të parasheh më pak dhe pastaj të thuhet se ne e kemi tejkaluar planifikimin por le të jetë më shumë planifikimi dhe ajo do të jetë një angazhim më i madh për qeverinë komunale që të punojnë në mënyrë që të arkëtojnë sa me tepër të hyra sepse sa më shumë të hyra vetanake, do të ketë me shumë buxhet dhe më shumë pastaj edhe realizim të projekteve që është në interes të qytetarëve. Presim që planifikimi i buxhetit për vitin 2021 të jetë sa më i arsyeshëm dhe më racional. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Cena, atëherë meqë nuk tjerë të lajmëruar, e lusë drejtorin nëse ka përgjigje.

**Afrim Limani** – z. Rasim Fazliu i ka bërë disa pyetje dhe unë konsideroj se Drejtoria e Shërbimeve Publike që fatbardhësisht e kemi drejtorin këtu dhe ka një planë për impiantin e ujërave të zeza dhe me se miri pjesa e KAB-it është e përshkruar të gjitha objektivat që janë mbi 13 objektiva në kuadër të drejtorisë së shërbimeve publike, gjithashtu është edhe plani për menaxhimin e mbeturinave. Ndërsa te numri i bizneseve sipas të gjitha gjasave pasi nuk pata mundësi me verifikua atëherë është një gabim teknik po një gjë e di se në faqen e parë të tabelorja, ne i kemi marrë shënimet me te sakta nga drejtoria për ekonomi se sa kanë qenë numri i bizneseve deri në atë periudhë të përgatitjes së KAB-it komunal. Por gjithsesi ju falënderoj shume pasi sipas të gjitha gjasave se është një gabim teknik që nuk është përmirësuar. Po ashtu edhe doktori bëri disa pyetje, unë e



thashë dhe ne fillim se ne duhet ta votojmë buxhetin me këto parametra pra limite buxhetore sepse formula na ka përcaktua se sa do të jetë buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2021 dhe si i tillë na kërkohet me aprovua. Thash edhe ne fillim KAB-in si dokument e kam përgatit pjesa teorike dhe gjitha objektivet dhe ka shume zbrazësi në KAB sepse nuk e dimë pa na ardhë qarkorja e dytë buxhetore për me ditë sakte se sa do të jetë buxheti sipas kategorive. Në momentin kur e kemi qarkoren e dytë buxhetore atëherë edhe këtë dokument KAB-in ne e përgatitim edhe e plotësojmë në hapësirat e zbrazëta. Tek të hyrat vetanake e thash edhe me herët pasi u bë një pyetje shume me vend, se tek të hyrat vetanake ne nuk mundemi me ndikuar pasi ata i caktojnë limitet, pra të hyrat vetanake i kanë caktuar saktë sa kanë qenë vitin 2020. Tash ne si drejtori e Financave i kemi konsultimet buxhetore me departamentin e buxhetit në kuadër të Ministrisë së Financave dhe aty ne i paraqesim kërkesat tona. Të njëjtën kërkesë e kam paraqit edhe vitin e kaluar, ku kam kërkuar që të hyrat vetanake të paktën të rriten edhe 10,000 euro sepse ne jemi të sigurt se kemi me arrit këtë objektiv edhe ashtu ndodhi, siç e dini edhe ju të gjithë se ne fund të vitit kemi pasur tejkalim të hyrave vetanake në vlerë prej 139,000 euro. Besoj që kësaj here kur kërkesën tonë do ta aprovojnë sepse kemi fakte argumente bindëse edhe kjo diferencë përafërsisht llogaritet mbi 100,000 euro me bo një kërkesë edhe këtë buxhete me adresue kuptohet që investimet kapitale pasi konsideroj që karshi nevojave dhe kërkesës që ka komuna e Rahovecit janë të pakta pra të vogla investimet kapitale me vlerë prej 3,300,000 euro. Faleminderit!

**Rasim Fazliu** – Unë desha me u lidhë me pyetjen e doktorit tek të hyrat vetanake, pasi është interesant që në vitet paraprake kur komuna ka realizuar më pak mjete pra të hyrat vetanake kanë qenë më të vogla atëherë planifikimin e bënin mbi 1,600,000 ndërsa tani kur ka ngritje të hyrave vetanake shkohet e kundërta me ulje të planifikimit, pra është për me u befasua me Ministrinë e Financave gjegjësisht me Qeverinë dhe nuk e di pse po ndodhin këto gjëra. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Fazliu, atëherë të nderuar kolegë meqë nuk kemi të tjerë të paraqitur, e qesim në votim pikën e tretë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

#### **4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-rregullores për taksa komunale.**

**Kryesuesi** – Të nderuar kolegë kuvendarë, para vetës e kemi rregulloren për taksa komunale. Në këtë draft rregullore, grupi punues ka punua një kohë jashtëzakonisht të gjatë mbi dy javë edhe pas orarit të punës edhe janë munduar që të japin të gjithë kontributin e vet duke harmonizuar të gjitha kodet aktuale por edhe kërkesat prej qeverisë. Gjithashtu rregullorja ka kaluar të gjitha procedurat si debatin publik ku kanë pasur mundësi të japin mendimin e vet edhe qytetaret kontributin e tyre. Gjithsesi edhe Kuvendi me datën 16 të këtij muaji ka organizuar punëtori për rregulloren për taksa, ku i falënderoj të gjithë për kontributin që kanë dhënë ku e kemi trajtua kodë për kodë dhe kemi dhanë mendimin edhe kontributin tonë. Po ashtu edhe ne mbledhjen e KPF-së e kemi trajtuar që gjithashtu edhe KPF-ja i ka rekomandua kuvendit që kjo rregullore të kaloj për kuvendë. Faleminderit

**Rasim Fazliu** – Faleminderit Kryesues, edhe ju e cekët se kemi pasur një punëtori ku kemi trajtuar në mënyrë të ngadaltë dhe kemi shkuar nen për nen këtë rregullore edhe i kemi harmonizuar qëndrimet të gjitha grupet politike që jemi, edhe kemi bërë disa korrigjime në përgjithësi por unë e kam vërejtur që ndoshta edhe kolegët tjerë me ndihmojnë, që ndoshta nuk janë përcjellë të gjitha ato korrigjime që kemi bërë aty, pasi janë disa lëshime që tash edhe me ndihmën e kolegëve do ta shohin se a është ashtu apo unë nuk e kam të qartë diçka. Përndryshe me këto lëshime që janë bërë, që ndoshta edhe dikush tjetër ka diçka dhe unë në emër të grupit them se i kemi krye punët ashtu siç duhet dhe duhet tash formalisht që ta aprovojmë këtë rregullore për taksa. Ne faqe 7, ka qenë lëshimi i certifikatës së përdorimit dhe kemi thënë se ajo duhet të kaloj te Drejtoria e

Urbanizmit kurse ka mbetur aty ku është nëse unë nuk gabohem pasi kështu ka qenë propozimi që kjo me kalua te Drejtoria e Urbanizmit por si duket nuk është kaluar. Pra në dokumentin që kemi pasur ne atë ditë në punëtori ne faqe 7 te neni 10, **taksa komunale administrative** pika 16 dhe 17 kemi thënë që duhet me kalua te Urbanizmi pasi kështu jemi dakorduar të gjithë që kemi qenë prezentë. Kurse kjo lëshimi i certifikatës së përdorimit ka mbetur prapë te administrata ndërsa **lëshimi i pëlqimit urbanistik dhe dokumenteve tjera urbanistike** që kemi thënë se duhet me qenë një vërtetim me quajt ashtu dhe të kaloj në urbanizëm, por ky dokument që na keni sjell për mbledhje të Kuvendit nuk ekziston as te administrata e as te urbanizmi, nëse jo atëherë mund të me ndihmoni pasi unë vetëm po e ngris si çështje. Ndërsa, është mirë që pika 18 këtu në nenin 10, **lëshimi i pëlqimit të dokumenteve tjera në fushën e emergjencës** kemi thënë te Inspeksioni dhe kjo si duket ka kaluar atje dhe është ne rregull tani. Pastaj kemi faqe 10, pika 11 **anamneza sociale** që kemi thënë që propozimi i kuvendit ka qenë 3 euro kurse nuk është e shënuar hiq në rubrikën si propozim i kuvendit dhe kërkoj që këto ndryshime të bëhen edhe sigurisht që në parim e kalojmë këtë Draft rregullore për taksa komunale. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Fazliu, me siguri gjatë punës duke bërë kanë mundur të ndodhë ndonjë lëshim teknik gjate shënimit gjithsesi Zyra Ligjore do të kujdeset për këtë për këto ndryshime. Unë konsideroj se ato janë bërë gjatë punës dhe ka mundur me pas ndonjë lëshim në njërën nga shtyllat në Draft rregullore.

**Fehmi Cena** – Ne si kuvendarë i kemi shqyrtuar draftin e parë të rregullores për taksa komunale në punëtorinë me 16 qershor, edhe unë mendoj se kemi bërë një punë të mirë pasi kemi shkuar për secilin shërbim që ofron komuna me dikasteret e veta. Nuk kanë qenë prezent të gjithë delegatët kuptohet kemi qenë një numër i konsiderueshëm edhe për hir të informimit në dy segmente isha kyq. E para për shëndetësi se edhe atë ditë nuk ka prezantuar drejtori komunal i shëndetësisë edhe sot të sqarohemi sepse besoj që edhe delegatët kanë pasur një draft material me herët ku janë prezantuar edhe disa të dhëna tjera rreth taksave në shëndetësi. Dhe vitin e kaluar ka qenë i formuar një grup profesional me kërkesën e drejtorisë komunale të Shëndetësisë për disa ndryshime në bashkëpagesa, në pjesën e shërbimeve shëndetësore mirëpo atë ditë kur e analizuam edhe zyrtari ligjor na tha që ne nuk kemi të drejtë me bo ndryshime në bashkëpagesa që paguajnë pacientët tanë kur ne si shërbyes shëndetësor i ofrojnë shërbimet tyre pranë institucioneve tona shëndetësore. Pra, është udhëzimi administrativ 04/2007 i Ministrisë së Shëndetësisë edhe ashtu do të mbetet pasi ne nuk po mundemi me bo ndryshime. Kërkesa ka qenë më tepër pasi ka pasur ndryshime nga komisioni pasi është kërkuar që të zbriten disa bashkëpagesa sidomos në fushën e stomatologjisë pasi vërtetë duken pak si të tepërta edhe qytetarët kanë pasur vërejtje mirëpo duke pasur parasysh se kjo nuk mundet me u ndryshua sepse është udhëzimi administrativ atëherë do mbetet ashtu. Ndërhyrja e dytë do ta bëjmë tek Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është në faqe 30, e konkretisht 31, është fjala për **shfrytëzimin e sallave dhe stadiumeve për subjektet politike**. Edhe atë ditë gjate punëtorisë e kemi debatuar këtë shërbim edhe disa kemi qenë që të mos tatimohet kjo pjesë pra të mos paguhet taksë sepse deri me tash nuk është paguar se kanë qenë të liruara për tubimet që i mbajnë subjektet politike nëpër salla dhe fusha të sportit. Pra atë ditë gjysma ishin kundër por unë personalisht nuk kam qenë kundër dhe ne jemi konsultuar me delegatët e grupit të LDK-së dhe jemi të mendimit se ky shërbim të mbetet pa taksë sikurse deri me tash, e jo të paguhet 50 euro edhe kisha kërkuar në këtë Kuvend të vendoset edhe kërkoj që delegatet të na përkrahin neve që të mbetet ashtu sikurse ka qenë, me arsyetimin se partitë politike nuk janë grupacione profitabile, nëse OJQ-të dhe të tjerët janë të liruar atëherë perse të mos lirohen edhe subjektet politike edhe ashtu ka qenë deri më tash. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Cena, ne e kemi diskutuar gjatë punëtorisë që kishim edhe partitë politike një herë në katër vjet i mbajnë 3 apo 4 takime, qëllimi edhe atë ditë kur kam marr fjalën e kam potencuar që meqë të gjithë duhet me paguar nga të gjitha organizatat atëherë edhe qytetarët tanë duhet ta dinë që edhe partitë

politike kur po e shfrytëzojnë një objekt apo sallë të paktën po e paguajnë një shume simbolike edhe unë sigurisht që ende qëndroj prapa asaj që ashtu si jemi marr vesh atë ditë që të jetë një kosto minimale që është prej 50 eurove. Sido që të jetë edhe pse ishim si të përgjysmuar mirëpo qëllimi ishte që me mbet ai propozim. Faleminderit!

**Rasim Fazliu** – Unë mendoj se jemi dakorduar ashtu gjatë punëtorisë por duhet ta kemi parasysh se kjo nuk shkon të njëjës apo tjetrës parti politike, pasi kjo vlen për të gjithë dhe nëse ne dakordohemi atëherë është mirë që mos me pagua edhe partitë politike pasi kjo shkon për të gjithë kështu që nuk është ndonjë problem dhe në parim mundën me aprovua rregulloren me ato lëshime që i cekëm me herët edhe me propozimin e doktorit edhe ne grupi i PDK-së e mbështesim që partitë politike mos të paguajnë. Faleminderit!

**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë kuvendarë. Unë po pajtohem plotësisht me pjesën e parë të z. Fazliu ku i dha ato vërejtjet për ndryshimet në tekstin e kësaj rregullore. Ne seancën e parë kur kemi marr vendim për me dal në debat publik, na është prezantuar se qëllimi i ndryshimit të kësaj rregullore është që të unifikohet një rregullore pothuajse e njëjtë për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës mirëpo secila komunë i ka specifikat e veta edhe ne jemi munduar që të ja përshtatim specifikat e komunës tonë. Ideja për me organizua punëtorinë për të cilën jemi takuar dhe jemi harmonizuar dhe i kemi diskutuar të gjitha kategoritë e taksave veç e veç dhe i kemi dhanë propozimet tona për të cilat jemi dakordue, besoj që ka dhënë rezultat dhe një praktikë e tillë është mirë me u ndjek për secilën rregullore sepse rregulloret janë dokumente të rëndësishme të Komunës tonë. Sa i përket propozimit të doktorit edhe atë ditë kemi qenë kundër por sido që të jetë ne mundemi edhe me i lirua por ajo shuma simbolike që është kërkuar të paguhet për shfrytëzimin e atyre hapësirave ndoshta kishte ndikuar sadopak në mirëmbajtje e atyre objekteve se vërtet sidomos shtëpitë e kulturës po dëmtohen me tepër kur po ka fushatë elektorale edhe ndoshta po ju bien me u shfrytëzua me shumë gjatë asaj kohe. Faleminderit!

**Dervish Çadraku** – Faleminderit kryesues, për këtë material ne kemi pasur një punëtori edhe e kemi shtjerrë debatin edhe jemi akordue që për krejt ato pika jemi marr vesh që sot me pas shumë debate por me kalua në mënyrë sipërfaqësore edhe sigurisht që ne nuk jemi fajtorë që nuk kanë marrë pjesë të gjithë pasi kanë munguar një numër i tyre dhe ne këtë pikë tash që folëm në këtë rast jemi dakorduar që kjo me qenë me pagesë edhe nuk ka pasur nevojë që me diskutua tani këtu përsëri sepse jemi marr veshë atë ditë, megjithëse unë mendoj që për me u mbyllë kjo bisedë atëherë është mirë që me dal në votim.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Çadraku, gjithsesi e ka dhënë kontributin ajo pjesë e punëtorisë që është bërë atje edhe do të procedojmë tutje/.

**Sali Sallteku** – Unë do të dal kundër z. Dervish Çadrakut pasi që të gjithë ata që ishin të pranishëm në punëtori po ata po bisedojnë edhe tani e jo të tjerët pasi kjo edhe atë ditë është biseduar dhe unë kam thënë tekstualisht se kjo do të nxjerrë probleme edhe pajtohem plotësisht me doktorin edhe unë mendoj se është mirë me qitë në votim, sepse vazhdimisht do të nxjerrë probleme. Sa i përket asaj që tha z. Morina me mbajt shpesh punëtori unë nuk pajtohem për këtë sepse është hargjim. Faleminderit shumë!

**Kryesuesi** - Faleminderit shumë z. Sallteku, edhe njëherë dua t'i falënderoj gjithë kolegët pjesëmarrës aty edhe çështja që e patëm debatuar atje, i kemi dhënë hapësirë që edhe në Kuvend ta trajtojmë edhe atë pjesë të lirimit të pagesës, megjithatë nëse ju kujtohet atje kur kemi qenë atë ditë edhe unë kam qenë që të paktën si arsyetim i pjesës qytetarëve, përndryshe është e vërtet që mundet me pas kapak telashe por gjithsesi pajtohem që edhe ta lirojmë edhe atë pjesë pasi nuk është diçka shumë e madhe.

**Fehmi Hoxha** – Është e vërtetë që jemi dakorduar mirëpo disa lëshime që foli edhe z. Rasimi dhe z. Cena që kemi lanë mundësi që edhe për kuvend me u marr vesh. Edhe një lëshim tjetër që me siguri nuk është shkruar pasi u dakorduam në të gjithë është çështja të neni 18 faqe 12 pika 4, **dhënia e pronës se paluajtshme të Komunës në shfrytëzim lokaleve afariste palestra sportive** me çmim fillestar nuk ka qenë por që tash po e bëjmë që edhe drejtori këtu e ka propozua 4 euro dhe ne e kemi diskutuar. Pra, atë ditë në parim u morëm vesh që të jetë 4 euro ka parku ndërsa lokalet prapa stadiumit të mbeten 2 euro dhe për këtë jemi dakorduar mirëpo këtu vetëm nuk e keni shënuar, pra vetëm këtë sugjerim të shkruhet 2 euro pasi ashtu jemi dakorduar. Pastaj te neni 20, çmimi fillestar për dhënie në shfrytëzim të tokës komunale ( ankand publik ) taksa mujore pika 1 është në rregull ndërsa pika 2 **qiraja për shfrytëzimin e tokës komunale me qëllim të vendosjes apo ndërtimit të objekteve të përkohshme për aktivitete biznesore** është si në vijim, pasi janë tarifat aty. Pra tek pika 2 është dhënia e tokës për vendosjen e kiosqeve kryesisht, pra janë ato ku ka hapësirë ku paraprakisht merren kushtet ndërtimore nga drejtoria e urbanizmit, nëse nuk ka hapësirë pra nuk ka kushte atëherë nuk mundet me kërkua. Kjo shkon direkt me kërkesë të drejtoria e shërbimeve publike e nuk shkon me ankand, pra pika e dyte nuk shkon me ankand por me kërkesë. Këto ishin dy sugjerimet e mia. Faleminderit shumë!

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Hoxha, atëherë të nderuar kolegë kuvendarë, para se me vu në votim, ne edhe në punëtori e kemi shqyrtuar dhe nuk ka qenë ndonjë arsye që me dëmtua dikë por po i referohem kolegut Sallteku që mundet ndoshta edhe të kemi probleme rreth mirëmbajtjes por mendimi ka qenë që duhet me pagua por megjithatë jemi ne ata që duhet të vendosim. Atëherë e vëmë në votim që të lirohen edhe subjektet politike. Me 14 vota pro, 13 kundër dhe 1 abstenim. Aprovohet propozimi që të lirohen edhe subjektet politike. Faleminderit shumë, tani e qesim në votim Draft-rregulloren për taksa komunale. Konstatohet se unanimisht aprovohet Draft rregullorja për taksa komunale. Të nderuar kolegë, propozoj 5 minuta pushim për harmonizim dhe ftojë shefat e grupeve në zyrën e Kryesuesit për harmonizim.

Të nderuar kolegë kuvendarë, rreth situatës aktuale që po bëhen ftesat nga Gjykata speciale, sigurisht që nuk është e pranueshme për secilin prej neve për çlirimtarët tonë gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që ishte edhe propozim i kolegut tonë z. Hoxha dhe në dakordim me shefat e grupeve parlamentare të Kuvendit, atëherë e ftojë z. Rasim Fazliu që ta lexoj deklaratën.

**Rasim Fazliu** – Me propozimin e dhënë nga shefave të grupeve të kuvendarëve nga radhët e partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Rahovecit për leximin dhe aprovimin e deklaratës, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.06.2020 unanimisht e aprovon këtë:

## DEKLARATË

Ne anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit, të zgjedhur si përfaqësues të qytetarëve të Komunës së Rahovecit, pavarësisht përkatësisë dhe orientimeve politike, përmes kësaj deklarate shprehim shqetësimin dhe kundërshtimin tonë në lidhje me ngritjen e aktakuzave në vazhdimësi dhe propozimin e Prokurorisë Speciale për ngritjen e aktakuzave ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në ditët e fundit, përkatësisht Presidentit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaqit dhe ish Kryeparlamentarit të Republikës së Kosovës z. Kadri Veselit.

Propozimet dhe deklaratat për opinion nga Prokuroria e Specializuar i konsiderojmë të padrejta dhe të pajustificueshme, pasi që lufta e drejtë e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës u mbështet edhe nga bota demokratike.

Me këtë rast kërkojmë nga institucionet kompetente vendore dhe ndërkombëtare që të punojnë seriozisht në drejtim të ndërprerjes së praktikave të tilla të ndjekjes së ish-komandantëve dhe luftës së pastër të UÇK-së dhe pjesëtarëve të saj, pasi është vërtetuar botërisht edhe nga institucionet më të larta të drejtësisë ndërkombëtare se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe e pastër.

Ne besojmë fuqishëm se lufta e UÇK-së ka qenë dhe do të mbetet e pastër, pavarësisht tendencave të vazhdueshme të Serbisë për kriminalizimin e saj. Ne e çmojmë lartë kontributin e çlirimtarëve në çlirimin dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës.

**Kuvendi Komunal – Rahovec, 29.06.2020**

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Fazliu, të nderuar kolegë kuvendarë e qesim në votim Deklaratën e Kuvendit Komunal të Rahovecit. Konstatoj se Kuvendin unanimisht e aprovon deklaratën që ishte me propozim të shëfave të grupeve parlamentare. Faleminderit shumë!

#### **5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për faljen e borxheve për taksë komunale.**

**Artan Asllani** – I nderuari Kryesues, të nderuar kuvendarë, ju kolegë drejtorë dhe gjithë ju të pranishëm. Para jush kemi prezantuar propozim vendimin për faljen e borxheve për të gjitha ato biznese që kanë ushtruar veprimtarinë e tyre për periudhën 2000 - 2017 mirëpo që realisht këto biznese janë mbyllura dhe kanë mbetur obligime ndaj taksës komunale. Komuna dhe kuvendi komunal çdo herë ka qenë në përkrahje të bizneseve dhe gjatë vitit 2017 dhe me plotësim ndryshimin e rregullores për taksa tarifa dhe ngarkesa, në vitin 2019 ka marr hapa të veprimit për përkrahjen e bizneseve të vogla, bizneseve prodhuese, artizanateve dhe bizneseve tjera. Duke parë dhe duke analizuar në kuadër të Drejtorisë së Ekonomisë dhe kërkesën e kahershme të kuvendarëve të Komunës së Rahovecit dhe kërkesën e vazhdueshme të auditorëve të jashtëm për rekomandimin zbutjen apo faljen e këtyre borxheve për të gjitha bizneset të cilat nuk ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të bërit biznes. Kërkoj nga ana juaj që sot ky propozim të votohet. Faleminderit shumë për mirëkuptimin tuaj!

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit shumë kryesues, po më vjen mirë që pas kërkesës së vazhdueshme që kam bërë ne 3 apo 4 seancat e fundit dhe propozimet që i kam bërë, që ky propozim vendim i kryetarit erdhi për faljen e borxheve për gjithë ata operatorë ekonomik të cilët aktualisht nuk funksionojnë ajo dihet që duhet një vërtetim nga ana e ATK-së të lirohen dhe kjo është shume mirë. Besoj që në të ardhmen edhe propozimet tjera që tu falen edhe 50% të gjithë atyre që kanë, do të na vije edhe propozimi i radhës ne seancat e radhës. Faleminderit shumë!

**Fehmi Cena** – Këtë pikë të rendit të ditës, pra këtë çështje e kemi shqyrtuar edhe ne mbledhjen e Komitetit për Politike dhe Financa dhe aty sa me kujtohet pikërisht kam kërkuar që në mbledhjen e Kuvendit të kemi disa të dhëna shtesë p.sh. se sa është numri i atyre bizneseve që do të falen nga borxhet që i kanë për taksat e tyre dhe veprimtarinë e tyre të ushtruar për një periudhë kohore goxha të gjatë sepse është periudhe nga 01.01.2000 e deri më 31.12.2017 afër 18 vite dhe dikush nuk e din sa ka zgjatë ajo periudhë, edhe është dashtë se paku numri i bizneseve të jetë edhe shuma e përgjithshme se sa do të jetë ajo shumë që komuna pretendon me i fal bizneseve të komunës tonë. Natyrisht që ne jemi shprehë pro mirëpo për Kuvend është dashtë me pas sqarime sepse këtu jemi 31 delegat që duhet të vendosim. Përndryshe nuk është mirë që kjo të bëhet shprehi për të ardhmen, se ka biznese që gjatë kësaj periudhe që kanë paguar kurse disa nuk kanë paguar dhe kjo nuk është e drejtë pasi dikush po falet dhe dikush ka paguar, si do të ndikoj në të ardhmen dhe unë besoj që ju keni menduar mirë si drejtori por kur ne nuk i shohim në shënime konkrete atëherë fitojmë përshtypje se ju megjithatë nuk e keni analizuar punën mirë dhe vetëm keni ardhë me një propozim blanco që keni menduar se

është mirë. Mendoj që mirë është me i dal në ndihmë por atëherë kur është e nevojshme dhe e domosdoshme pra atëherë duhet bizneseve të ju dilet në ndihmë. Faleminderit!

**Rasim Fazliu** – Ne këtë problem e kemi pasur në vazhdimësi si Komunë, pra, gjithmonë është ngritur kjo çështje edhe nga Auditori i Përgjithshëm edhe çdo herë ka dalë si borxh por faktikisht ky nuk është një borxh kur bizneset nuk punojnë. Dhe unë konsideroj që pika 2 e thotë qartë këtu, falja e borxh të papaguar për bizneset të cilat nuk punojnë dhe të cilat janë të shuara dhe nuk e ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznesore. Pra është vendim i qartë dhe i qëlluar sepse e thash edhe me herët se gjithmonë figuronte si vërejtje ndaj komunës tonë e cila ka ndikuar negativisht në performancën e komunës. Kështu që, është mirë që ka ardhur ky propozim vendim dhe ne do ta mbështesim këtë vendim edhe jam për atë që të shlyhen këto borxhe që të mos figurojnë. Faleminderit!

**Masar Popaj** – Desha të di për bizneset që nuk kanë paguar gjatë kësaj periudhe 2000-2017 dhe i njëjti person hap përsëri biznes, si do veprohet me atë person i cili me parë e ka shlye biznesin dhe prapë dëshiron me hap një biznes tjetër.

**Artan Asllani** – Rreth pyetjes që bëri z. Fehmi Cena, ne në vendim në koordinim me Zyrën Ligjore nuk e kemi parë të arsyeshme me qitë edhe numrin e bizneseve dhe totalin e vlerës që kanë mbetur këto biznese në taksa mirëpo ne e kemi edhe një material që ndoshta ka qenë edhe gabim nuk e kam bashkëngjite propozim vendimit për juve, që bëhet fjalë 661 biznese që realisht nuk janë duke punuar dhe kanë mbetur në obligime afër 280,065 euro ndërsa 63% komuna e Rahovecit i ka të liruara bizneset nga taksa dhe po ashtu i ka mbi 500 biznese që janë aktive me taksë mirëpo ky Kuvend për këtë vit për tre muaj e ka bërë faljen për periudhën mars-maj të vitit 2020. Sipas komisioneve që realisht ka shumë biznese që gjatë kësaj periudhe janë hapur për një arsye apo tjetër dhe ne e dimë që gjatë viteve 2000-2005 kanë qenë disa grande që kanë mundur me përfitua qytetarët që janë kthyer nga vendet tjera të Evropës dhe kanë hapë biznese mirëpo nuk kanë qenë aktive dhe pasi që zyrtari përkatës e bën verifikimin çdo vit bizneseve edhe ju ka vendos ngarkesën mirëpo ata individë apo pronar të bizneseve asnjëherë nuk kanë ardhë edhe me i pa këto obligime edhe realisht borxhi ju ka ngarkuar për shkak se edhe zyrtari nuk ka pasur faj, sepse nuk e ka ditë a është aktiv apo jo. Te pyetja e Masarit për të gjitha ato biznese që morëm vendim për faljen e borxheve dhe nëse çel ndonjë biznes tjetër si do të veprojmë me ata. Ai biznes hapet i ri dhe me emër tjetër që mundet me qenë edhe me emër të vetin që po ashtu mundet me qenë me të njëjtin profil e që realisht me dokumente është biznes i ri dhe nuk kemi asgjë të veprojmë kundër tij. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë drejtor për sqarimin, të nderuar kolegë kuvendarë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar për këtë pikë, e hedhim në votim pikën e pestë të rendit të ditës. Konstatojmë se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës me një abstenim.

**Mbledhja përfundoi 12:10**

01 Nr. 06/2020  
Rahovec, 29.06.2020

**Procesmbajtësi:**

**Agim Hoti**

**KRYESUESI**

**Afrim Dina**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC



# RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

JANAR – QERSHOR 2020

*Që nga marrja e përgjegjësisë për të drejtuar Komunën e Rahovecit,  
Unë personalisht dhe bashkëpuntorët e mi jemi duke punuar me qëllim të shtuar dhe orar të  
zgjatur për të zgjidhur sa më shumë probleme, për të realizuar sa më shumë investime publike  
që rrisin cilësinë dhe mirëqenien e përgjithshme të dhe për të avancuar sa më shumë shërbimet  
komunale ndaj qytetarëve.*

- Smajl Latifi-

Kryetar i Komunës së Rahovecit

|                                                                                        |                                                             |  |
|----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|--|
|                                                                                        | REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO |  |
| KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC                        |                                                             |  |
| KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL AUTHOR CABINET |                                                             |  |
| Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)                                 |                                                             |  |
| Nr./Br./No 917                                                                         | Nr. i faq./Br.str./No.pg 92                                 |  |
| Data/Datum/Date 26 / 06 / 2020                                                         |                                                             |  |
| RAHOVEC / ORAHOVAC                                                                     |                                                             |  |



### PËRMBAJTJA

|                                                                           |    |
|---------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>KRYETARI I KOMUNËS</b> .....                                           | 2  |
| <b>Zyra Ligjore</b> .....                                                 | 7  |
| <b>Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit</b> .....              | 8  |
| <b>Zyra e Prokurimit</b> .....                                            | 9  |
| <b>Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura</b> .....                       | 9  |
| <b>Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun</b> .....                | 12 |
| <b>Zyra e Auditimit të Brendshëm</b> .....                                | 13 |
| <b>Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim</b> .....                       | 13 |
| <b>Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut</b> .....                     | 14 |
| <b>Zyra për Integritet Evropian</b> .....                                 | 15 |
| <b>Zyra për Barazi Gjinore</b> .....                                      | 15 |
| <b>SEKTORI PËR LEKTORIM</b> .....                                         | 16 |
| <b>DREJTORIA PËR ADMINISTRATË</b> .....                                   | 16 |
| <b>DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET</b> .....                             | 19 |
| <b>DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE</b> .....             | 22 |
| <b>DREJTORIA PËR ARSIM</b> .....                                          | 24 |
| <b>DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM</b> .....                  | 27 |
| <b>DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT</b> ..... | 29 |
| <b>DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE</b> .....                               | 31 |
| <b>DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL</b> .....           | 34 |
| <b>DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË</b> .....                   | 38 |
| <b>DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT</b> .....                        | 40 |
| <b>DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE</b> .....                               | 46 |
| <b>DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM</b> .....                           | 49 |
| <b>PËRFUNDIM</b> .....                                                    | 50 |

**KRYETARI I KOMUNËS****Fjala hyrëse**

Qytetarë të komunës së Rahovecit,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2020, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin gjashtëmuor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – qershor 2020.

Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e drejtorive komunale në Komunën e Rahovecit si dhe njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.

Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë, progresin e arritur në realizimin e prioriteteve të Komunës dhe ka si pikë reference Programin e Qeverisë Komunale.

Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale. Raporti gjashtëmuor i punës është mjet i komunikimit i të arriturave të pushtetit lokal, përkushtimit, angazhimit dhe vendosmërisë së treguar, në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Rahovecit.

**Synimet politike në qeverisje:**

- Qeverisje të mirë, të përgjegjshme, të qëndrueshme, të hapur me qytetarët, demokratike dhe të suksesshme;
- Qeverisje me plane dhe shikim kah e ardhmja;
- Qeverisje që gjen zgjidhje, sado sfiduese dhe komplekse janë problemet;
- Qeverisje me plane të qarta dhe ambicioze;
- Qeverisje që përballlet me guxim dhe kryen punë me dinamikë të lartë e nuk vonohet;
- Qeverisje që afirmon vlerat kombëtare, historike, të trashëgimisë, të kulturës dhe vlerat e tjera;
- Qeverisje energjike që mobilizon resurse dhe përfshin në veprime investuese e zhvillimore punën në partneritet;
- Qeverisje e cila vlerëson, motivon dhe mbështet talentin dhe të arriturat e qytetarëve tanë të të gjitha shtresave;
- Qeverisje ndërtuese që promovon gjithëpërfshirjen në vendimmarrje të forcave me ndikim në shoqëri, si: forcat politike, Kuvendin Komunal, bashkësitë fetare, shoqërinë civile, bizneset, individët, të rinjtë dhe grupet e ndryshme të interesit;
- Qeverisje që mobilizon qytetarët të marrin rolin që ju takon në të gjitha çështjet që janë në interesin e tyre;

- Qeverisje për të gjithë, pa dallim.

**Prioritetet tona kryesore për Rahovecin vazhdojnë të jenë:**

- Rahoveci një vend i dëshirueshëm për të jetuar, për të punuar dhe për të mbajtur familjen;
- Të përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve, në rritjen e nivelit të kënaqshmërisë së qytetarëve me ofrimin e shërbimeve dhe informim publik cilësor;
- Komunë me performancë të mirë dhe qeverisje demokratike;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne;
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë;
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit;
- Realizim i planit të të hyrave komunale;
- Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të reja;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;
- Rritja e rolit dhe shtimi i aktiviteteve të inspektoratit;
- Edukim dinjitoz i brezave të rinj duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse;
- Ofrimi i mjediseve për rekreacion, ngjarjeve kulturore dhe programe për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve të të gjitha moshave, me theks të veçantë në mirëqenien e rinisë;
- Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit të sigurtë dhe efikas të qarkullimit në trafik;
- Shtimi dhe mirëmbajtja e parqeve, hapësirave publike, objekteve rekreative, rrugëve, ndërtesave dhe infrastrukturës tjetër me qëllim të arritjes së standardeve të larta të dukjes dhe gjendjes së tyre;
- Vizita sistematike shëndetësore nëpër të gjitha shkollat;
- Nxitje të investimeve dhe projekteve në turizëm;
- Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë e biciklistë;
- Rritje e përkrahjes për bujqësinë dhe rritje e përkrahjes direkte për fermerët;
- Projekte për kullimin e tokave bujqësore;
- Rritje e cilësisë dhe investime në arsim;
- Bursa për studentë;
- Investime në nyjat sanitare dhe meremetim të shkollave;
- Ndërtimi i shkollave dhe çerdheve të reja;
- Eficienca e energjisë në objektet shkollore dhe në objektet e tjera publike;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm;
- Komunikim dhe bashkëpunim me OJQ-të.

**Punë konkrete për Rahovecin:**

- Hartimi i planit vjetor të prokurimit dhe aprovimi i tij, hartimi i planit vjetor të punës së Kryetarit dhe qeverisë komunale;
- Nxjerrje e urdhëresave, vendimeve dhe akteve të shumta në interes të komunës dhe të qytetarëve tanë;
- Pas rreshjeve të borës kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit menjëherë kanë dalur në terren për pastrim të rrugëve, falë reagimit të shpejtë të kompanive nuk ka pasur vështirësi dhe pengesa në qarkullim të lirë të automjeteve;
- Komuna e Rahovecit u rendit e para nga 38 komunat e Kosovës nga Instituti Demokratik i Kosovës KDI për transparencë dhe llogaridhënie komunale, në kuadër të Transparimetrit komunal, i cili u zhvillua për vitin 2019 në të gjitha komunat e Kosovës.
- Sikurse vitin e kaluar, kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe;
- Bashkë me UN-Habitat kemi vazhduar procesin e planifikimit dhe shpalljes së konkursit ndërkombëtar për hartimin e projektit ideor të sheshit qendror të qytetit në Rahovec;
- Kemi filluar të përgatisim paramasat për projektin "Riparime në Shkollë", përkatësisht për riparimin e njeve sanitare dhe dyshemeve të shkollave, në Shkollën e Mesme Profesionale kemi përfunduar 3 kabinete: kabinetin e makinerisë, kabinetin e teknologjisë informative dhe kabinetin e shkencave juridike;
- Kemi bërë analizimin e kontratave dhe përmbushjen e tyre në projektet si: trotuare, rrugë, rreth-rrotullime, hapësira publike, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, të martirëve, të civilëve, poashtu të shesheve, pllakave përkujtimore, të hapësirave të gjelbëruara etj;
- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, plan mjedisor që është hartuar për herë të parë në Komunën e Rahovecit, pasi është dalë në shqyrtim publik me lejen e Kuvendit të Komunës së Rahovecit është miratuar në seancën e marsit në Kuvendin Komunal Rahovec;
- Projekti i ndërtimit të tetë parqeve në Komunën e Rahovecit ka vazhduar edhe në këtë fillimvit, ka vazhduar ndërtimi i parkut në Sopniq, në Pataqan të Poshtëm, në Malësi të Vogël, në Dobidol dhe ndërtimi i oborrit të shtëpisë së fshatit në Senoc. Do të vazhdohet edhe me ndërtimin e parqeve në Celinë, Zogisht dhe Ratkoc.
- Kemi përfunduar projektin e pompave të ujit në fshatin Pastasel, uji është testuar dhe ka ardhur deri në rezervuarin shpërndarës, i është dërguar kërkesa KRU "Gjakova" për pranimin e punëve dhe për mirëmbajtje, ku dhe kemi përfunduar së bashku me zyrtarë të ujësjellësit ujin e pijshëm;
- Projekti për rregullimin e rrugëve fushore ka vazhduar dhe është punuar në të tri lotet, kryesisht në fshatrat: Lot 1: Dejnë, Vrajak, Ratkoc, Malësi e Vogël, Lot 2: Rahovec, Senoc, Pastasel, Drenoc, Kaznik, Polluzhë, Nushpallë, dhe Lot 3: Hoçë e Vogël, Brestoc, Nagac.

- Në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës dhe menaxhimit të situatës nga përhapja e Covid-19, Komuna e Rahovecit ka ngritur në nivel të lartë gatishmërinë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi, duke ndërmarr masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit nga Virusi Korona (COVID-19).
- Kemi bërë dezinfektimin e të gjitha objekteve dhe institucioneve publike, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit, si: objektet shëndetësore (QKMF, QMF-të, AMF-të), objektet e Administratës Komunale, objektet fetare: (Xhamitë dhe Teqetë), Stacioni i Autobusëve, Stacioni Policor, objekte kulturore dhe sportive. Vlen të theksohet se objektet shëndetësore dezinfektohen çdo vikend, ndërsa reparti i mjekësisë familjare dhe kujdestaria dezinfektohen dy herë në javë për shkak se janë më të frekuentuara nga qytetarët tanë.
- Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me kompanitë për mirëmbajtje dhe falë ndihmës së KRU "GJAKOVA", ndihmës së fermerëve tanë të cilët ju kanë përgjigjur thirrjes për t'ju dalur në ndihmë kompanive dhe vullnetarëve të angazhuar, në mënyrë që i gjithë procesi të kryhet sa më mirë që është e mundur, ka bërë pastrimin e rrugëve, lagjeve në të gjithë territorin e komunës së Rahovecit, poashtu, është bërë edhe pastrimi i deponive ilegale;
- Në mënyrë që të ofrojmë shërbime profesionale dhe të sigurta për qytetarët, tashmë kemi marrë vendim që në të dy QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, edhe ditën e shtunë të punohet me orar të rregullt;
- Në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal, është miratuar propozim-vendimi i Kryetarit, z.Smajl Latifi, për miratimin e mjeteve financiare në vlerë prej 10.000 euro, për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19. Më anë të këtij vendimi kemi vënë në dispozicion 10.000 (dhjetëmijë) euro, mjete këto që do të shfrytëzohen për mbulimin e kërkesave dhe nevojave të Shtabit të Posaçëm Emergjent, më saktësisht për menaxhimin e situatës së krijuar nga ky virus, duke përfshirë këtu furnizimin me barna ose përkrahjen për rastet sociale;
- Sipas vendimit të qeverisë, janë mbyllur të gjitha kafiteritë, baret dhe restaurantet, me përjashtim të farmacive dhe marketeve ushqimore;
- Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë Nr/08 Pika nr.9, kam marrë vendim që të reduktohet stafi i zyrtarëve komunal në të gjithë sektorët, përveç: personelit shëndetësor dhe Inspektoriatit komunal, si masë preventive ndaj infeksionit (COVID -19);
- Është bërë pezullimi i të gjitha tubimeve, manifestimeve apo evenimenteve publike deri në një njoftim të radhës;
- Kemi përfunduar me krijimin e tri shtigjeve të ecjes në fshatrat Dejnë, Drenoc si dhe në pikën turistike Zhdrellë, punimet kanë filluar edhe në fshatin Krushë e Madhe për ndërtimin e projektit të Shtegut të Ecjes, " LULET E MARSIT";
- Ka përfunduar shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë të Komunës së Rahovecit, e cila është duke u bërë në përputhje me listat e përpiluara në bashkëpunim me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit , Qendrën për Punë Sociale në Rahovec dhe Kryqin e Kuq;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve nga Hoça e Madhe deri në Krushë të Madhe ka vazhduar në tremujorin e dytë, në kohën kur ka filluar të përmirësohet moti. Punimet momentalisht janë duke vazhduar në: Brestoc, Nagac dhe Krushë të Madhe.



- Është në fazën e projektimit projekti për ndërtimin e varrezave të deshmorëve dhe martirëve në fshatin Celinë si dhe rregullimin e renovimin e të gjitha pllakave, përmendoreve, pllatove, rrethojave të vend-rënieve në komunën e Rahovecit. Pas përfundimit të hartimit të projektit do të nisim procedurat publike për lidhjen e kontratës.
- Ka vazhduar ndërtimi i serave të pa përfunduara pas shpalljes së rezultateve nga komisioni, duke përmbyshur kontratën aktive në kuadër të kësaj kontrate janë ndërtuar 15 serra 3 ari dhe 11 sera 5 ari.
- Ndërtimi i shtatores për heroin Feim Gashi është përfunduar, është përfunduar edhe shkrirja në bronz, është planifikuar në prill të vendoset së bashku me shtatoren e heroit, vëllait të Feimit, Bedrush Gashi, në qendër të fshatit Drenoc, mirëpo për shkak të pandemisë, vendosja e shtatoreve është shtyrë në një afat të pacaktuar;
- Ka përfunduar ndërtimi i lapidarit “Altari i Lirisë”, kushtuar martirëve të fshatit Guri i Kuq. Lapidari është zbuluar më 14 qershor, në ditën e Çlirimit të Rahovecit;
- Është lidhur kontrata për mbjelljen e mbi 10 mijë drunjve në komunën e Rahovecit. Deri më tani nga kjo kontratë janë mbjellë rreth 3500 drunj, do të vazhdohet mbjellja e tyre sipas kohës optimale;
- Në Çifllak po vazhdojnë punimet për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare! Ky projekt kap vlerën prej 82,996 eurove, punimet pritet të përfundojnë në muajin korrik të vitit 2020.
- Nga ana e Kryetarit, z.Smajl Latifi janë nënshkruar dy marrëveshje të mirëkuptimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR). Sipas këtyre marrëveshjeve, MZHR bashkë me Komunën e Rahovecit do të financojnë dy projekte, konkretisht: projektin: “Renovimi i Stacionit të autobusëve dhe kabinave inovative” në vlerën: 100.000 euro, si dhe projektin: “Ndërtimi i rrugës në fshatin Zaqisht”, në vlerën: 30.000 euro.
- Në këtë periudhë kanë vazhduar punimet në ndërtimin e rrugës Rahovec-Hamoc-Fortesë, është duke u punuar në segmentin e dytë nga Rahoveci në drejtim të Brestocit, jemi në fazën e instalimit të infrastrukturës nëntokësore, në ndërtimin e mureve mbrojtëse, ujit të pijshëm, kanalizimit, etj;
- Kanë vazhduar punimet në kuadër të projektit “Restaurimi i monumenteve kulturore – historike” të projekteve rreth trashëgimisë kulturore, kujdesi për objektet në listën e mbrojtës së trashëgimisë kulturore dhe caktimi në listë të atyre që duhet të ruhen, evidentimi dhe përkufizimi i vlerave kulturore e historike të objekteve të trashëgimisë kulturore. Në kuadër të këtij projekti, kanë vazhduar punimet edhe në Bunarin e Madh në Ratkoc;
- Në objektin e ri të çerdhes Tulipanët ka vazhduar pajisja me inventarin e nevojshëm, proces ky i cili po vazhdon, por ende nuk ka përfunduar;
- Në objektin e shkollës “Nesimi Elshani” në Nagavc ka filluar projekti i eficiencës së energjisë, ku fillimisht ka filluar puna në instalimin e ndriçimit eficient e pastaj do të vazhdohet me instalimin e ngrohjes qendrore dhe punëve të tjera të parapara sipas projektit.

## Zyra Ligjore

## Fushëveprimtaria e Zyrës Ligjore

- Zyra Ligjore ofron ndihmë juridike, shërbime dhe këshillime për drejtori, zyra dhe sektorë, institucionet dhe ndërmarrjet komunale;
- Shqyrton të gjitha projekt-rregulloret që propozuesit ia dërgojnë për miratim Komiteteve kompetente dhe Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmëri me ligjet ekzistuese në fuqi dhe Statutin e Komunës;
- Harton (përpilon) vendime, aktvendime, pëlqime, urdhëresa, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje, leje pune, leje ndërtimi dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe trupat e formuar nga organet komunale.
- Shqyrton propozimet e rregulloreve dhe akteve të tjera që i propozohen Kuvendit të Komunës për miratim, përgatit dhe harton rregulloret dhe urdhëresat administrative që i lëshon Kryetari i Komunës, merr pjesë në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara, merr pjesë në të gjitha seancat e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të formuara nga Kuvendi i Komunës, Zyra si strukturë organizative kryen edhe punë të tjera që i caktohen me ligj, Statutin e Komunës dhe rregulloret e tjera në fuqi.

## Objektivat e arritura:

*Në periudhën janar-qershor 2020, Sektori Ligjor në Komunën e Rahovecit ka arritur këto objektiva:*

|                                                                                            |            |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| Rregullore                                                                                 | 1          |
| Plotësim dhe Ndryshim i Rregulloreve                                                       | 0          |
| Vendime për Kryetarin                                                                      | 219        |
| Vendime për Kuvend                                                                         | 25         |
| Urdhëresa                                                                                  | 28         |
| Autorizime                                                                                 | 6          |
| Kërkesa                                                                                    | 12         |
| Opinione Ligjore                                                                           | 1          |
| Marrëveshje                                                                                | 5          |
| Propozime për Kuvend                                                                       | 8          |
| Akte përcjellëse                                                                           | 42         |
| Kontrata                                                                                   | 5          |
| Konsultime                                                                                 | permanente |
| Përgjigje në kërkesë                                                                       | 26         |
| Njoftime                                                                                   | 0          |
| Deklarata                                                                                  | 0          |
| Puna në Komisione                                                                          | 15         |
| <b>Totali i akteve të hartuara për periudhën janar-mars 2020 nga Sektori Ligjor është:</b> | <b>393</b> |

**Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit****Rekrutimet**

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur 2 konkurse, për angazhim të stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, janë pranuar në punë 28 punëtor me MVSH, për kohëzgjatje më pak se 6 muaj.

**Pushimet vjetore**

Një pjesë e punonjësve të Administratës Komunale në Rahovec nuk kanë pasur mundësi të shfrytëzojnë pushimin vjetor për vitin 2020, si pasojë e pandemisë COVID-19.

**Lëshimi i akteve administrative**

Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka lëshuar 28 Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për punëtorët e rinj, poashtu, janë lëshuar 65 shkresa të ndryshme administrative.

**Tabelat statistikore**

Të dhënat statistikore të personelit, Njësia e personelit i procedon drejtpërdrejtë në programin elektronik SIMBNJ, sipas kërkesës së MAP/DASHC-së, që bëhet rregullisht. Njësia e personelit të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë i siguron nga zyrtarët e atyre dy sektorëve.

**Komisioni Disiplinor**

Në Komisionin Disiplinor nuk ka pasur asnjë lëndë disiplinore.

**Vijueshmëria e punëtorëve në punë**

Funksionon Sistemi i Mbikëqyrjes së Vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP, u janë dërguar drejtorive raportet e vijueshmërisë së punëtorëve për çdo muaj: janar, shkurt dhe mars 2020.

**Plani individual i personelit**

Njësia e personelit ka hartuar Planin Individual të Personelit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020 dhe është hartuar në mënyrë elektronike sipas programit SIMBNJ.

**Administrimi i programeve elektronike**

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që kanë të bëjnë me burimet njerëzore si në vijim:

- Menaxhon me programin elektronik SIMBNJ që dmth. Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punë të punëtorëve, pra, programin SMVP.
- Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED që në nivel shtetëror është kompetent ASHI-Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP.



- Monitoron me programin elektronik PYROLL, pra programit të listave, pagave dhe pagesave të komunës

## Zyra e Prokurimit

### Gjatë periudhës raportuese Zyra e Prokurimit ka kryer këto aktivitete:

- Përgatitja e Raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2019 e dorëzuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) dhe e publikuar në ueb-faqe të Komunës: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/prokurimi/raportet-e-prokurimit/>;
- Përgatitja e Planifikimit Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2020 e dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP) dhe e publikuar në ueb faqe të Komunës: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/prokurimi/planifikimet-e-prokurimit/>;
- Përgatitja e Raportit të Obligimeve Financiare dhe Kontraktuale të dorëzuar në Drejtorinë për Financa dhe Buxhet;
- Zyra e Prokurimit ka filluar me procedura të reja të prokurimit për vitin 2020, ku deri më tani janë në procedurë: 28 aktivitete të prokurimit;
- Personeli i Zyrës së Prokurimit deri më tani ka proceduar: 600 urdhërblerja, pagesa të ndryshme të Investimeve Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime.

## Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

Zyra për Përfaqësim Ligjor (ZPL) e Komunës së Rahovecit kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, në bazë të praktikës së Avokaturës Publike Komunale dhe Ligjit për Avokaturën Shtetërore.

### Regjistrat:

Regjistri për lëndë (procedurë) civile "C";

- Regjistri për lëndë (procedurë) përmbare "P";
- Regjistri për lëndë (procedurë) administrative dhe konfliktet administrative "KA";
- Regjistri për lëndë (procedurë) të ndryshme "CN";
- Regjistri për lëndë (procedurë) at-hezionit "PA" dhe
- Regjistri për lëndë të brendshme administrative "ZPL".

Pasqyra tabelare (si më poshtë) për të gjithë regjistrat, paraqet lëndë në punë, të pranuar, të kryera, të pakryera dhe lëndë të mbetura si dhe pasqyra për aktivitetet e ndërmarra.

### LËNDË TË REJA TË PRANUARA GJATË VITIT 2020:

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

|   | Sipas regjistrave të ZPL         | Civile | Përmbartimore | Proc. Administrative – konflikt Administrativ | CN Ndryshme | Proc. At. hezionit | Gjohat Mandatore | Avokatura | Gjithsej punë të kryera: |
|---|----------------------------------|--------|---------------|-----------------------------------------------|-------------|--------------------|------------------|-----------|--------------------------|
| 1 | Lëndë të pa zgjidhura-të bartura | 846    | 82            | 5                                             | 30          | 14                 | 0                | 19        | 996                      |
| 2 | Lëndë të pranuar                 | 15     | 4             | 4                                             | 1           | 0                  | 0                | 5         | 29                       |
| 3 | Të gjitha lëndë në punë          | 861    | 86            | 9                                             | 31          | 14                 | 0                | 24        | 1025                     |
| 4 | Lëndë të zgjidhura               | 8      | 3             | 0                                             | 0           | 0                  | 0                | 17        | 28                       |
| 5 | Lëndë të mbetura                 | 835    | 83            | 9                                             | 31          | 14                 | 0                | 7         | 979                      |

### PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUDHËN RAPORTUESE:

| Sipas regjistrave të ZPL          | Civile | Përmbartimore | Konfliktet Administrativ | Civile të ndryshme | Penale at-hezionit | Ndryshme Avokatura | Gjithsej: |
|-----------------------------------|--------|---------------|--------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|-----------|
| <b>TË PRANUARA:</b>               |        |               |                          |                    |                    |                    |           |
| Vendimet e shk. I-prë             | 24     | 1             | 0                        | 0                  | 0                  |                    | 25        |
| Vendimet e shk. II-të             | 1      | 1             | 0                        | 1                  | 0                  | 1                  | 2         |
| Vendimet e shk. III-të            | 2      | 0             | 0                        | 0                  | 0                  |                    | 2         |
| Aktgjykim+Aktvendim OHPGIS        | 3      |               |                          |                    |                    |                    | 3         |
| Urdhër Përmbartimor               |        | 2             |                          |                    |                    |                    | 2         |
| Aktvendim për 180 ditë            | 12     |               |                          |                    |                    |                    | 12        |
| Padi me prova                     | 13     |               | 0                        | 0                  |                    |                    | 13        |
| Aktvendim për përgjigje në padi   | 8      |               | 0                        | 0                  |                    |                    | 8         |
| Përgjigje në ankesë civile        | 2      |               | 0                        | 1                  |                    |                    | 3         |
| Përgjigje në ankesë përmbartimore |        | 0             |                          |                    |                    |                    | 0         |
| Përgjigje në prapësim             |        | 0             |                          |                    |                    |                    | 0         |
| Përgjigje në revizion             | 0      |               |                          |                    |                    |                    | 0         |
| Precizimi i padisë të paditësit   | 3      |               |                          |                    |                    |                    | 3         |
| Ankesë civile e paditësit         | 1      |               | 1                        |                    |                    |                    | 1         |
| Ankesë përmbartimore e paditësit  |        | 1             |                          |                    |                    |                    | 1         |
| Ekspertizat                       | 1      |               |                          |                    |                    |                    | 1         |
| Parashtresat tjera të pranuar     | 4      | 0             |                          |                    |                    |                    | 4         |

|                                                |    |    |   |   |   |   |    |
|------------------------------------------------|----|----|---|---|---|---|----|
| <b>Gjithësej shikuesat e pranuarat</b>         | 75 | 6  | 1 | 2 | 0 | 1 | 80 |
| <b>TË DËRGUARA:</b>                            |    |    |   |   |   |   |    |
| <b>Ankesat</b>                                 | 6  | 1  | 0 | 1 |   |   | 8  |
| <b>Përgjigje në ankesat</b>                    | 0  |    | 0 |   |   |   | 0  |
| <b>Përgjigje në Padi</b>                       | 4  |    | 0 |   |   |   | 4  |
| <b>Mbrojtje në Padi DHP QPS</b>                | 0  |    |   |   |   |   | 0  |
| <b>Revizionet</b>                              | 0  |    |   |   |   |   | 0  |
| <b>Përgjigje në revizionet</b>                 | 0  |    | 0 |   |   |   | 0  |
| <b>Prokurimi për Mbrojtjen e Udhëheqësve</b>   | 0  |    | 0 |   |   |   | 0  |
| <b>Përgjigje në mbrojtjen të Udhëheqësve</b>   | 0  |    |   |   |   |   | 0  |
| <b>Propozimet</b>                              |    | 2  |   |   |   |   | 2  |
| <b>Udhëtimet e padisë</b>                      | 0  |    | 0 |   |   |   | 0  |
| <b>Udhëtimet e propozimeve për përmbarimin</b> |    | 8  |   |   |   |   | 8  |
| <b>Përafrimet e gjatë të dërguara</b>          | 0  | 0  | 0 |   |   | 8 | 9  |
| <b>Përafrimet e dërguara dhe boritave</b>      | 8  | 5  | 1 |   |   |   | 14 |
| <b>Gjithësej shikuesat e dërguara</b>          | 15 | 16 | 1 | 1 | 0 | 8 | 41 |

Të gjitha shkresat e pranuarat janë sistemuar nëpër lëndë përkatëse dhe është vepruar në interes të Komunes varësisht nga rasti. Vendimet e pranuarat gjyqësore të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë pas analizimit të tyre, ato të cilat kanë qenë në dëm të Komunes janë kontestuar në shkallë tjetër gjyqësore.

Seancat e caktuara nga kontestet civile, përmbarimore, etj. nga gjykatat për periudhën raportuese.

Për të gjitha lëndët aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore në të cilat Komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

| Seancat gjyqësore gjatë vitit 2019 | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Gjithsej |
|------------------------------------|-------|--------|------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|----------|
| <b>Nr.i seancave të mbajtura</b>   | 14    | 16     | 11   | 0     | 0   | 0       | 0      | 0     | 0       | 0     | 0      | 0       | 41       |
| <b>Sipas kontesteve</b>            |       |        |      |       |     |         |        |       |         |       |        |         |          |
| <b>Civile</b>                      |       |        |      |       |     | 40      |        |       |         |       |        |         |          |
| <b>Përmbarimore</b>                |       |        |      |       |     | 0       |        |       |         |       |        |         |          |
| <b>Konflikte Administrative</b>    |       |        |      |       |     | 0       |        |       |         |       |        |         |          |
| <b>Civile Ndryshe</b>              |       |        |      |       |     | 1       |        |       |         |       |        |         |          |
| <b>Proc.At. hezionit</b>           |       |        |      |       |     | 0       |        |       |         |       |        |         |          |
|                                    |       |        |      |       |     | 41      |        |       |         |       |        |         |          |



### Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në Komunën e Rahovecit, është angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

Lajmet, njoftimet dhe dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me Zyrën e Kryetarit, Kryesuesit dhe drejtorive komunale, janë publikuar në ueb-faqe dhe të njëjtat janë dërguar për publikim në portalet locale, gjithashtu edhe në ato nacionale, është përgatitur plani për dokumentet komunale që do të kalojnë procedurat e debateve dhe konsultimeve publike, i njëjti është publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës, poashtu është përgatitur regjistri për evidencën e kërkesave të pranuar dhe përgjigjeve të dhëna për Qasje në Dokumentet Publike të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në ligin për QDP Nr. 06L-081.

Poashtu, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun ka përcjellur të gjitha seancat e Kuvendit Komunal, për të cilat me kohë janë njoftuar edhe gazetarët, gjithashtu, ka përcjellur edhe të gjitha mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë publikuar vendimet e nënshkruara të kryetarit në uebfaqe zyrtare. Në vazhdimësi vendimet e nënshkruara nga Kryetari janë dërguar te zyrtari përgjegjës për pranimin e vendimeve në MAPL.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është përgatitur plani për dokumentet komunale që do të kalojnë procedurat e debateve dhe konsultimeve publike, i njëjti është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës.

Është përgatitur regjistri për evidence e kërkesave të pranuar dhe përgjigjeve të dhëna për Qasje në Dokumentet Publike të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në ligin për QDP Nr. 06L-081, në fund të vitit apo nëse kërkohet nga institucionet që na monitorojnë, publikimi i këtij regjistri me të gjitha detajet do të publikohet në uebfaqe e komunës, por që ky dokument sigurisht që do të publikohet në fund të vitit 2020, një dokument i tillë është duke u bërë për herë të parë, pasi që në të kaluarën është publikuar raporti vjetor për QDP me informata të shkurtëra.

**Gjatë muajve janar- qershor 2020 janë publikuar: aktivitete-dokumente, detajet mund t'i shihni në tabelën e mëposhtme:**

| Muajt   | Lajme | Njoftime | Ftesa | Thirrje | Konkurse | Vendime | Ankande | Debate | QDP | Nr.i aktive tve |
|---------|-------|----------|-------|---------|----------|---------|---------|--------|-----|-----------------|
| Janar   | 24    | 10       | 0     | 1       | 1        | 19      | 0       | 1      | 2   | 58              |
| Shkurt  | 17    | 5        | 0     | 0       | 6        | 21      | 0       | 1      | 0   | 50              |
| Mars    | 44    | 21       | 0     | 1       | 0        | 9       | 0       | 0      | 1   | 76              |
| Prill   | 50    | 17       | 0     | 0       | 16       | 1       | 0       | 0      | 0   | 84              |
| Maj     | 24    | 5        | 0     | 2       | 49       | 1       | 0       | 1      | 1   | 83              |
| Qershor | 9     | 4        | 1     | 2       | 39       | 0       | 0       | 1      | 0   | 56              |

### Zyra e Auditimit të Brendshëm

Në kuadër të këtij gjashtëmujori, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin Vjetor të Punës për vitin 2020, i cili ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit. Ndërsa, bazë ligjore ka pasur Ligjin për Auditim të Brendshëm (LAB), Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

#### Aktivitetet në periudhën: janar- qershor

- Në muajin janar, angazhimet tona kryesisht kanë qenë në verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të AB dhe Auditorit të Përgjithshëm të dhëna në auditimet e kaluara, si dhe përgatitja e raportit të gjashtëmujorit të dytë dhe raportin vjetor të NJAB-së për vitin 2019.
- Në muajin shkurt është bërë verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në vitin 2019.
- Raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2019 i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komisionit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Si aktivitete të tjera mund të cekem edhe ofrimi i ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha drejtoritë komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rreziqeve në implementimin e rekomandimeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke krijuar një regjistër me rreziqe të identifikuar, ashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të drejtorive.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

**Vlerësimi përmbyllës: Në këtë periudhë (janar-qershor), NJAB-ja nuk ka arritur objektivat e planifikuara në bazë të Planit Vjetor, pasi që nuk ka arritur ti kryejë dy (2) auditime, për shkak të pandemisë nuk ka qenë e mundur të kryhet aktiviteti i auditimit të brendshëm në Drejtorinë për Punë Inspektuese.**

### Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, ZKK ka kryer rregullisht punët e saj në fushëveprimin që i takon.

#### Aktivitetet në periudhën: janar-qershor

- Në kuadër të koordinimit dhe implementimit të aktiviteteve në bazë të planit vjetor të ZKKK-së, janë realizuar 12 takime të rregullta me stafin e ZKK-së;
- Me qëllim të verifikimit të kërkesave për kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur jashtë territorit të Kosovës dhe Komunës së Rahovecit, ZKKK-ja në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe IOM ka realizuar vizitë zyrtare në Serbi, në kuadër të vizitës "SHIKO-VEZHGO";
- Janë shqyrtuar mbi 12 kërkesa për kthim të familjeve nga Serbia, 8 prej tyre janë aprovuar unanimisht dhe 4 të tjera janë shtyer për ri-shqyrtim në mungesë të kompletimit të të gjitha dokumentacioneve, në bazë të rregullores në fuqi;
- Në kuadër të projektit "PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË KOMUNËN E RAHOVECIT" kanë filluar punimet e rrugës në fshatin Xërxë dhe fshatin Çifllak, në kubëzimin e venbanimeve të komuniteteve;
- ZKKK në bashkëpunim me Organizatën IOM, ka nënshkruar vazhdimin e projekteve për mbështetjen e komuniteteve, për projektet kapitale dhe mbështetjen me grante (pajisje) për start-up biznese dhe zgjerim të tyre ndaj komuniteteve jo-shumicë.
- Ka filluar ndërtimi i shtëpisë në kuadër të projektit RRK V –IOM.

### Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

Duke u bazuar në objektivat që i ka të planifikuara për realizim të aktiviteteve gjatë gjithë vitit, NJKDNI në tremujorin e parë të këtij viti për zbatim, monitorim dhe raportim mbi zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi promovimin dhe përhapjen e vlerave në fushën e të drejtave të njeriut, e në veçanti të gruas si dhe fuqizimi, integrimi i saj në jetën shoqërore, ka realizuar një sërë aktiviteteve.

#### Aktivitetet në periudhën: janar- qershor

- Me projektin e Ri-Atdhesimit kanë përfunduar tri (3) shtëpitë që ishin duke u ndërtuar gjatë vitit 2019, poashtu, është bërë edhe mobilimi i tërësishëm i këtyre shtëpive;
- Janë mbajtur dy takime të rregullta në kuadër të ditës së hapur me qytetarë me këshilltarin e lartë juridik të Avokatit të Popullit;
- Pas trajnimit për Platformën për të Drejtat e Njeriut – me kërkesen e MAPL-së, kemi aritur të hapim linkun në ueb-faqen zyrtare të Komunës, i cili do të shërbejë për lehtësimin e punës për të gjithë punonjësit e Administratës Komunale;
- Pas një pune të gjatë që kemi bërë me disa nga gra të dhunuara gjatë luftës, duke ju ndihmuar në aplikacione për komision, Komisioni Qendror na ka njoftuar se 4 prej tyre ju është njohur statusi dhe tani do të jenë të kompenzuar nga 230€ në muaj, nga muaji prill.



### Zyra për Integritet Evropian

Zyra për Integritet Evropian ka kryer funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011, për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integritet evropian, në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integritet Evropian.

#### Aktivitetet:

Mbikëqyrja e aktiviteteve të drejtorive që burojnë nga PKZMSA-ja, si dhe dokumentet e tjera strategjike të MAPL-së dhe Qeverisë së Kosovës;

Obligimet e komunave që dalin nga Agjenda Evropiane, duke u bazuar në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit;

#### Procesi i ri- integritetit për personat e riatdhesuar:

Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të përbashkëta, banimi përmes qirasë, regjistrimi civil dhe pajisja me dokumente personale, përfshirja e të riatdhesuarve në përfitimet nga skemat sociale sipas legjislacionit në fuqi, verifikimin e rasteve në terren në bashkëpunim me koordinatorin regional dhe futja e të dhënave në SMR-në.

### Zyra për Barazi Gjinore

Edhe pse në komunën tonë sfida në vetvete mbetet implementimi i Ligjit për Barazi Gjinore dhe arritja e barazisë gjinore, falë mbështetjes komunale, organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si dhe angazhimit të përbashkët të të gjithë aktereve, si dhe i ZBGj, kemi arritur të realizojmë një pjesë bukur të madhe të aktiviteteve të parapara për këtë periudhë gjashtëmujore, njëherit të bazuara në Planin Vjetor të Punës për arritjen e barazisë gjinore.

Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me grupin joformal të grave, kemi shënuar aktivitete të ndryshme si: shënimi i festës së Gruas, 8 Marsit, dorëzime të statistikave gjinore në Komunën e Rahovecit ku është mbajtur evidencë rreth statistikave gjinore, si në: administratën komunale, shëndetësi, arsim dhe për banorët e Komunës, në baza etnie dhe gjinore.

**SEKTORI PËR LEKTORIM****JANAR-QERSHOR**

Gjatë këtij gjashtë mujori, kam lektoruar dokumentet e nxjerra nga Kryetari i Komunës, që ka lëshuar Zyra Ligjore, të tjera që kanë ardhur nga drejtoritë, nga Kuvendi Komunal dhe nga komitetet e Kuvendit (procesverbale dhe vendime), si dhe dokumente të tjera të adresuara tek unë.

|                                               |            |
|-----------------------------------------------|------------|
| <b>Vendime</b>                                | <b>200</b> |
| <b>Urdhëresa</b>                              | <b>16</b>  |
| <b>Kërkesa</b>                                | <b>67</b>  |
| <b>Përgjigje në kërkesa</b>                   | <b>2</b>   |
| <b>Njoftim</b>                                | <b>3</b>   |
| <b>Propozim</b>                               | <b>5</b>   |
| <b>Letërkonfirmim</b>                         | <b>1</b>   |
| <b>Marrëveshje</b>                            | <b>5</b>   |
| <b>Shkresa</b>                                | <b>1</b>   |
| <b>Zyra e Personelit</b>                      | <b>2</b>   |
| <b>Drejtoria e Financave</b>                  | <b>1</b>   |
| <b>Drejtoria e Bujqësisë</b>                  | <b>1</b>   |
| <b>Letërkonfirmim</b>                         | <b>1</b>   |
| <b>KKSB ( Raport i punës)</b>                 | <b>1</b>   |
| <b>KPF (procesverbal)</b>                     | <b>6</b>   |
| <b>Kuvendi (procesverbal)</b>                 | <b>6</b>   |
| <b>Kuvendi Komunal ( vendime)</b>             | <b>7</b>   |
| <b>KKSB ( procesverbal)</b>                   | <b>2</b>   |
| <b>Komiteti për Komunitete (procesverbal)</b> | <b>1</b>   |
| <b>Gjithsej:</b>                              | <b>328</b> |

**DREJTORIA PËR ADMINISTRATË**

Raporti i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në vazhdim pasqyron punën e kësaj Drejtorie për periudhën: janar - qershor 2020, punë kjo e realizuar në përputhje me Statutin e Komunës, Planin e Punës, ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe vendimet në fuqi.

Si një segment i rëndësishëm i Komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal po thuaj se çdo ditë, Administrata Komunale gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, edhe përkundër shfaqjes së pandemisë COVID-19, dhe stafit të

reduktuar, DA, ka bërë përpjekje që të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, duke ju ofruar qytetarëve të saj, si në aspektin kohor dhe atë cilësor realizim të të drejtave të tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës, me kohë maksimale të pritjes 5 minuta, për të gjitha shërbimet që i ofron administrata. Në këtë drejtim fokusi ka qenë realizimi i synimeve programore, respektimi dhe zbatimi i ligjit si dhe akte të tjera juridike, të gjitha këto si parakushte për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, gjithmonë në shërbim të përmbushjes së kërkesave individuale dhe të përgjithshme të qytetarëve, pa asnjë dallim.

### Sektori i Gjendjes Civile

Sektori për Gjendje Civile në gjashtëmuorin e parë të vitit 2020 ka realizuar punët bazuar në ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative mbi dokumentet dhe lëshimin e dokumenteve zyrtare. Ky sektor ka kryer veprime të shërbimit të gjendjes civile siç janë: plotësimi, përditësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile, zhvillimi i procedurave administrative, mbajtja e akteve të gjendjes civile, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile si dhe veprimeve të tjera juridike administrative në pajtim me legjislacionin në fuqi.

| DOKUMENTET E LËSHUARA NGA SISTEMI I GJENDJES CIVILE |  |            |            |
|-----------------------------------------------------|--|------------|------------|
| Komuna                                              |  | Data prej: | Data deri: |
| Rahovec                                             |  | 01.01.2020 | 31.05.2020 |
| Lloji i dokumentit :                                |  |            |            |
| Certifikatë lindje                                  |  |            | 8063       |
| Certifikatë martese                                 |  |            | 1,557      |
| Certifikatë vdekje                                  |  |            | 330        |
| Certifikatë vendbanimi                              |  |            | 432        |
| Certifikatë të bashkësisë familjare                 |  |            | 1,502      |
| Certifikatë të gjendje martesore                    |  |            | 622        |
| Certifikatë shtetësie                               |  |            | 80         |
| Lëshimi i vërtetimeve nga arkivi                    |  |            | 431        |
| Totali                                              |  |            | 13,017     |

**Vërejtje:** në këtë pjesë të raportit, përpos lëshimit të dokumenteve të gjendjes civile, numerikisht evidentohen – hyjnë në sistemin elektronik edhe verifikimet e dokumenteve të ndryshme personale sipas kërkesave të qytetarëve – palëve.

Siç shihet nga ky raport, sektori i gjendjes civile ka qenë mjaft efikas dhe funksional në lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile dhe zhvillimin e procedurave administrative për rregullimin e çështjeve të gjendjes civile sipas kërkesave të palëve.

### Sektori i Teknologjisë Informative

Sektori i Teknologjisë Informative ka vazhduar me zbatimin e planifikimit vjetor të punëve si dhe punëve të përditshme siç janë: monitorimi i rrjetit, sistemeve, përkrahja e zyrtarëve etj.



- Gjatë kësaj periudhe raportuese sektori i teknologjisë informative ka bërë testimin e kabllave prej burimit të pikave ndërlidhëse deri te kompjuterët, printerët dhe pajisjet e tjera, poashtu, është bërë pastrimi i rregullt i serverëve, bartja e incizimeve nga kompjuteri i sallës së kuvendit në NAS;
- Është bërë instalimi sistemit operativ windows 10 në ato kompjutera ku kemi patur mundësi dhe paketën e office;
- Gjatë kësaj periudhe kemi bërë dorëzimin e printerëve të operatorit "RIKON" dhe kemi filluar pranimin e pajisjeve nga operatori tjetër "Arthouse" ku kemi filluar shpërndarjen e tyre dhe konfigurimin dhe instalimin;
- Ka pasur mjaft kërkesa për përkrahje Ad-Hoc, të cilave iu jemi përgjigjur (intervenim në kompjutera, përkrahja në krijimin e dokumenteve të ndryshme etj);
- Në vazhdimësi jemi duke u marrë me sistemin e intranetit dhe ku ka nevojë e bëjmë edhe përkrahjen te stafi që ka nevojë për shfrytëzimin e këtij sistemi, në intranet me kërkesë të drejtorëve janë bërë ndryshimet në kodet ekonomike dhe shenjave të klasifikimit.
- Gjatë kësaj periudhe kemi krijuar edhe disa llogari në active directory për zyrtar që janë pranuar me kontratë mbi vepër, këto janë kryer me kërkesë të drejtorëve të drejtorive që i kanë pranuar këta zyrtarë.
- Planifikimi për mbajtjen e trajnimeve me stafin e komunës në lidhje me përdorimin e aplikacioneve dhe sistemeve elektronike nuk është realizuar për shkak të pandemisë.
- Në QSHQ janë bërë disa ndryshime dhe ne është dashur që krahas ndryshimeve të e përshtasim edhe infrastrukturën e rrjetës në këtë pjesë.

### Sektori për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve

- Ndërmarrje e të gjitha masave të nevojshme për organizimin më të mirë të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, përgatitja e materialeve të nevojshme, dërgimi i ftesave dhe çështje të tjera rreth organizimit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës (6 mbledhje) të Kuvendit Komunal;
- Organizimi i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa;
- Dërgimi i të gjitha akteve në MAPL, sipas kërkesës së tyre;
- Përpilimi dhe lektorimi profesional të materialeve literare në gjuhët zyrtare në Komunën e Rahovecit.

### Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të objekteve

- Sektori për mirëmbajtje, logjistikë dhe sigurim të objekteve, brenda kompetencave ka kryer punët rutinore pa ndonjë specifikë, ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbrim etj).
- Kemi menaxhuar me racionalitet të plotë dhe të domosdoshëm me fushën e logjistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësore e të cilave është Komuna e Rahovecit,

duke ushtruar në permanencë mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servisimin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimin transparent me derivate etj.

### Qendra për Shërbime me Qytetarë

Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, për këtë periudhë raportuese është arritur ngritja e bashkëpunimit me të gjitha drejtoritë e administratës komunale, organet e komunës dhe njësitë e tjera për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/lëndëve, brenda afateve ligjore.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë – Sektorit Pritës – Protokoll, ka qenë mjaft efikase dhe funksionale në realizimin e lëndëve si të përfunduara – vendosura lëndët sipas kërkesave të qytetarëve me kohë dhe brenda afateve ligjore, d.m.th. të gjitha lëndët janë përfunduar sipas Ligjit të Procedurës Administrative, me çka mund të thuhet se shërbimi ndaj qytetarëve ka qenë në nivelin shumë të kënaqshëm. Gjithashtu, nivel i kënaqshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve ka qenë edhe në drejtoritë e tjera të Administratës Komunale që me kohë kanë përfunduar – vendosur lëndët sipas kërkesave/parashtresave të qytetarëve, edhe përkundër shfaqjes së pandemisë COVID-19.

Përmes Qendrës për Shërbime me qytetarë arrihet edhe komunikimi i drejtpërdrejtë, korrekt dhe transparent me qytetarët dhe bizneset, dhënia e ndihmës profesionale për paraqitjen e kërkesave dhe parashtresave, njohja e qytetarëve me informacionet e nevojshme lidhur me kushtet, procedurat administrative, ligjore, afatet kohore të paraqitjes dhe trajtimit të kërkesave dhe parashtresave si në formën klasike ashtu edhe përmes formës elektronike /intranetit, përgatitja dhe vënia në dispozicion të broshurave dhe fletëpalosjeve informative për qytetarët, mbajtja e dosjeve, statistikave të parashtresave dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët, shtypjen e librit të protokollit për kërkesat/parashtresat, vëzhgimi i reagimeve të qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës ndaj shërbimeve që ofron qendra etj.

### DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

Drejtoria për Financa dhe Buxhet ka përgatitur raportin e punës për periudhën: (janar- qershor 2020), i cili është një përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të cilat janë kryer gjatë kësaj periudhe raportuese, bazuar në : Ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret të cilat e rregullojnë fushën të cilën e mbulon DPF, bazuar edhe në programin e punës së Kryetarit të Komunës, planin e punës së drejtorisë, bazuar në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit komunal, inkasimit të të hyrave vetanake, mbajtjen e lidhjeve dhe korrespondencave me ministritë e linjës e në veçanti me Ministrinë e Financave.

***Më poshtë po paraqesim në vija të shkurtëra disa nga punët dhe aktivitetet më kryesore në sektorë të drejtorisë:***



**Sektori për Buxhet dhe Financa**

Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë, ne si drejtori kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie.

Në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, kemi arritur që detyrat dhe obligimet që dalin para kësaj drejtorie të kryhen në afate ligjore duke evidentuar dhe regjistruar të gjitha të hyrat sipas kategorive të tyre, si dhe shpenzimin e buxhetit të të gjitha kategorive.

Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi mbajtur takime të ndryshme me MF-në, Asociacionin e Komunave të Kosovës, organizata të ndryshme apo donator, takime këto në të cilat kryesisht janë trajtuar çështjet financiare. Te shpenzimet operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime, kryesisht Mallra dhe Shërbime, pa e dëmtuar Buxhetin në kategori të tjera, duke i rritur disa shpenzime-shërbime të cilat në të kaluarën janë paguar nga kapitalet e realisht kanë qenë Mallra dhe Shërbime, siç janë: mirëmbajtja e ndërtesave dhe rrugëve, pastrimi i rrugëve, rrënimi i objekteve pa leje, sinjalizimi i rrugëve etj.

Në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, janë realizuar detyrat kryesore duke respektuar edhe afate ligjore të rregulluara me ligjet që rregullojnë financat publike.

**Komuna e Rahovecit për vitin 2020 ka operuar me një Buxhet prej: 14,735,820.00 euro, të përbërë nga Grandi Qeveritar dhe të Hyrat Vetanake:**

|                           |                        |
|---------------------------|------------------------|
| <b>Grandi i qeveritar</b> | <b>13,578,979.00 €</b> |
| <b>Të hyrat vetanake</b>  | <b>1,156,841.00 €</b>  |
| <b>Gjithsej</b>           | <b>14,735,820.00 €</b> |

**Shpërndarja e buxhetit nëpër kategori ekonomike në vitin 2020 është siç vijon:**

|                            |                       |
|----------------------------|-----------------------|
| <b>Paga e mëditje</b>      | <b>8,644,820.00 €</b> |
| <b>Mallra dhe shërbime</b> | <b>1,594,330.00 €</b> |
| <b>Shpenzime komunale</b>  | <b>280,500.00 €</b>   |
| <b>Subvencione</b>         | <b>311,001.00 €</b>   |
| <b>Investime kapitale</b>  | <b>3,905,770.00 €</b> |

**Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi realizuar këto detyra:**

- Zotime, pranime, shpenzime për Mallra dhe Shërbime ,shërbime komunale ,subvencione dhe transfere ,investime kapitale dhe përgatitja e ndryshimeve në listën e pagave për punëtorë;
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujore 2020 për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës;
- Raportimi i obligimeve financiare në baza mujore në Ministrinë e Financave;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore(shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në Web faqen e Komunës;
- Përgatitja e KAB-it 2021-2023 për Kuvend;


- Përgatitja e dokumentacionit për bartjen e mjeteve nga viti 2019 për Kuvendin Komunal dhe Ministrinë e Finanave;
- Përgatitja e shkresave, kërkesave të ndryshme gjatë kësaj periudhe.

### JANAR-QERSHOR BUXHET,ALOKIM,SHPENZIM

| Përshkrimi                                 | Lëndët e kryera | Buxheti fillestar | Buxheti final     | Alokimet         | Shpenzimet       | Shpenzim Buxhet fillestar % | Shpenzim Buxheti final % | Shpenzim Alokim % |
|--------------------------------------------|-----------------|-------------------|-------------------|------------------|------------------|-----------------------------|--------------------------|-------------------|
| Paga dhe Mëdtije                           | 49              | 7,556,821         | 7,578,747         | 3,192,857        | 3,168,786        | 41.93                       | 41.81                    | 99.25             |
| Mallra dhe Shërbime                        | 935             | 1,594,330         | 1,605,914         | 771,994          | 459,611          | 28.83                       | 28.62                    | 59.54             |
| Shpenzime Komunale                         | 211             | 280,500           | 280,500           | 140,250          | 97,017           | 34.59                       | 34.59                    | 69.17             |
| Subvencione dhe Transfere                  | 27              | 311,000           | 311,000           | 170,000          | 15,650           | 5.03                        | 5.03                     | 9.21              |
| Investime Kapitale                         | 142             | 3,905,770         | 4,272,089         | 3,385,816        | 2,093,847        | 53.61                       | 49.01                    | 61.84             |
| Rezervat (për zbatimin e ligjit të pagave) | -               | 1,087,399         | 1,087,399         | 0                | 0                | 0.00                        | 0.00                     | N/A               |
| <b>Totali</b>                              | <b>-</b>        | <b>14,735,820</b> | <b>15,135,649</b> | <b>7,660,916</b> | <b>5,834,911</b> | <b>39.60</b>                | <b>38.55</b>             | <b>76.16</b>      |

**Sqarim:** Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për shkak të bartjes së mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2019 si dhe alokimi i huamarrjes në Arsimin Fillor .

### PARAQITJA GRAFIKE:



**Të hyrat vetanake**

Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2020 janë 1,156,841,00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumë 382,998,29 apo 33,11 % të planifikimit vjetor.

**Sektori i Tatimit në Pronë**

- Objekte të reja të regjistruara: 121 objekte ose 22,048 m<sup>2</sup>;
- Verifikim i pronave ekzistuese: 910 , ose 196,309m<sup>2</sup>;
- Të hyrat e realizuara: gjatë periudhës janar-qershor 2020, Sektori i Tatimit në Pronë ka realizuar të hyra prej 123,852,96 euro apo 22,89 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 541,173.00€);
- Përqindja e realizimit të Tatimit në Pronë, në raport me vitin 2018 të njëjtës periudhë është (71,523,79) apo (57,70 ) %.

*Vërejtje: Të gjitha të dhënat që janë të paraqitura janë përgatitur në bazë të raporteve deri më 15.06.2020*

**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE**

Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë kësaj periudhe raportuese ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë.

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në Planin e Punës për vitin 2020. Ky raport përfshin në mënyrë gjithpërfshirëse shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitë e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

**Aktivitetet në periudhën: janar- qershor**

DSHMS qysh në fillim të vitit 2020 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësisë të përshkruara, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planifikuara, janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimit - shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar ofrimi i shërbimeve mjekësore me dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, poashtu, në fshatrat Dejnë dhe Ratkoc është shënuar përvjetori i dhurimit vullnetar të gjakut, dhurimi vullnetar i gjakut ka vazhduar edhe në fshatrat e tjera të komunës sonë.

Muaji mars, është karakterizuar me një sërë aktiviteteve dhe masa të ndërrmarra nga Komuna e Rahovecit, si drejtori në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës dhe menaxhimit të



situatës nga përhapja e Covid-19, kemi ngritur në nivel të lartë gatishmërinë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi, duke ndërmarr masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit nga Virusi Korona (COVID-19).

Në mënyrë që të ofrojmë shërbime profesionale dhe të sigurt për qytetarët, tashmë kemi marrë vendim që në të dy QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, edhe ditën e shtunë të punohet me orar të rregullt. Në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal, është miratuar propozim-vendimi i Kryetarit, z.Smail Latifi për miratimin e mjeteve financiare në vlerë prej 10.000 euro, për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19. Më anë të këtij vendimi kemi vënë në dispozicion 10.000 (dhjetë mijë) euro, mjete këto që do të shfrytëzohen për mbulimin e kërkesave dhe nevojave të Shtabit të Posaçëm Emergjent, më saktësisht për menaxhimin e situatës së krijuar nga ky virus, duke përfshirë këtu furnizimin me barna ose përkrahjen për rastet sociale.

Kemi bërë dezinfektimin e të gjitha objekteve dhe institucioneve publike, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit, si: objektet shëndetësore (QKMF, QMF-të, AMF-të), objektet e Administratës Komunale, objektet fetare: ( Xhamitë dhe Teqetë), Stacioni i Autobusëve, Stacioni Policor, objekte kulturore dhe sportive etj. Vlen të theksohet se objektet shëndetësore dezinfektohen çdo vikend, ndërsa reparti i mjekësisë familjare dhe kujdestaria dezinfektohen dy herë në javë për shkak se janë reparte më të frekuentuara nga qytetarët tanë.

### LISTA E OBJEKTEVE TË DEZINFEKTUARA NË KOMUNËN E RAHOVECIT

| Objektet e dezinfektuara        | Numri i objekteve                                                           | Dezinfektimi nga: |
|---------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| QKMF, QMF-të, AMF-të            | 14- objekte shëndetësore                                                    | Komuna Rahovec    |
| Objekte fetare                  | 24 -xhami në tërë Komunën e Rahovecit                                       | Komuna Rahovec    |
| Objekte fetare                  | 2 -teqet në Rahovec                                                         | Komuna Rahovec    |
| Objekte kulturore dhe sportive  | Palestra Sportive, shtëpitë e kulturës                                      | Komuna Rahovec    |
| Objekti i pasaportave           | 1 – Kompetencë e MPB                                                        | Komuna Rahovec    |
| Stacioni i autobusëve           | 1-Stacioni i autobusëve në Rahovec                                          | Komuna Rahovec    |
| Stacionet Policore              | 2- Stacioni policor në Rahovec dhe nënstacioni Policor në Zoqisht           | Komuna Rahovec    |
| Objektet e Komunës së Rahovecit | 2- Objektet e Administratës Komunale në Rahovec, të dezinfektuara në tërësi | Komuna Rahovec    |
| Institucione të drejtësisë      | Objekti i Gjykatës Themelore Gjakovë- dega në Rahovec                       | Komuna Rahovec    |
| Institucione arsimore           | Çerdhja "Tulipanët" në Rahovec                                              | Komuna Rahovec    |
| Sektori privat                  | Kompanitë private që kanë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve         | Komuna Rahovec    |

Komuna e Rahovecit, përkatësisht DSHMS-ja, së fundmi ka planin operativ duke caktuar edhe vendin për ngritjen e një karantine e cila në rast nevojë, do të përdoret me qëllim të menaxhimit të rasteve të ekspozuara ndaj virusit, sipas nevojës. Pas situatës së krijuar nga rreziku i infeksionit COVID-19, të gjithë

njerëzit e vullnetit të mirë, individë e biznese, po vazhdojnë, traditën, humanizmin dhe solidaritetin, në mbështetje të qytetarëve, duke dhuruar kështu donacione të ndryshme si: pako ushqimore dhe higjienike, destilat, dezinfektues për duar, ndihmë në vlerë monetare etj. Shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike është duke u bërë në përputhje me listat e përpiluara në bashkëpunim me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit, Qendrën për Punë Sociale në Rahovec dhe Kryqin e Kuq.

Si drejtori vazhdimisht jemi ballafaquar me mungesë të materialit mbrojtës për personelin mjekësor si maskat mbrojtëse, dorëzat, dezinfektues, rroba mbrojtëse dhe syza mbrojtëse për personelin shëndetësor që janë vija e parë e frontit me COVID-19.

#### **Ecuria e realizimit të projekteve kapitale**

- Ndërtimi i QKMF-së, faza e dytë dhe përfundimtare, projekti deri më tani ka arritur në 80%, besojmë se deri në muajin korrik, shpejtë do të përfundojmë objektin e QKMF-së dhe Emergjencës;
- Në Çifllak po vazhdojnë punimet për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare! Ky project kap vlerën prej 82,996 eurove, punimet pritet të përfundojnë në muajin korrik të vitit 2020.

#### **Mirëqenia Sociale:**

Në kuadër të aktiviteteve nga fusha e mirëqenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushëveprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendorë dhe të huaj, poashtu, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare. Pra, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia.

Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

### **DREJTORIA PËR ARSIM**

Në këtë raport të Drejtorisë Komunale për Arsim janë pasqyruar aktivitetet dhe punët që janë kryer në 6 mujorin e parë të vitit 2020. Këto aktivitete janë zhvilluar sipas planifikimeve të bëra të planit vjetor të punës, përkatësisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë këtyre 6 muajve. Mirëpo, në 3 muajt e fundit të kësaj periudhe u krijua një situatë e pa parashikur, si rezultat i shfaqjes së pandemisë COVID-19. Si rrjedhojë e gjendjes së re të krijuar, ne kemi bërë edhe punë të pa parashikuara në planin vjetor. Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të përmbledhura në dy etapa me nga 3 muaj, siç vijon:



## Aktivitetet në periudhën janar - mars

- Në fillim të janarit u realizua procesi i trajnimit të Ekipeve të Vlerësimit të Brendshëm të të gjitha shkollave, trajnim ky i cili u zhvillua gjatë pushimit dimëror. Në këtë trajnim u përfshinë të gjitha ekipet e secilës shkollë, me gjithsej 190 pjesëmarrës.
- Më 10 Janar u mbajt një takim informues i thirrur nga zyrtarët e MASHT dhe KEC për procesin e aplikimit të shkollave në Projektet e Granteve Shkollore të financuara nga Banka Botërore dhe mbështetur nga MASHT. Në këtë takim morën pjesë drejtorët e shkollave që kanë përgatitur projektpropozimet edhe nga komuna jonë.
- Pranuar një donacion nga KFORI Italian, të cilin e dedikuar për nxënësit e Shfmu "Gëzim Hamza-Piktori". Ky donacion u dhurua si rezultat i bashkëpunimit të DKA-së me Kforin Italian dhe përmban mjete konkretizimi dhe pajisje laboratorike për lëndën e fizikës.
- U mbajtën garat shkollore të Fizikanëve të Rinjë, ndërsa më 18 Janar u mbajt Gara Komunale e Fizikanëve të Rinjë me nxënësit fitues të klasave 9,10, 11 dhe 12. Poashtu, nëpër shkolla kanë janë mbajtur garat shkollore për Olimpiadën e Matematikës, gara komunale e së cilës u zhvillua më 25 janar.
- Realizuar një takim me Caritas-in e Zvicrës ku u konsultuar për fillimin e realizimit të projektit "Shpresë", përmes të cilit 6 klasa parafillore do të pajisen me inventar dhe do të bëhet trajnimi i të gjitha edukatoreve.
- Është mbajtur takimi i dytë i Ekipit për Parandalimin e Braktisjes dhe Reagimit ndaj Mosregjistrimit të nxënësve.
- Kemi mbajtur takime me përfaqësues të operatorëve që kanë kontratë në ndërtimin e shkollave dhe çerdheve, në të cilat kemi biseduar për rifillimin e punimeve në realizimin e projekteve. Nëpër të gjitha shkollat ka vazhduar themelimi i Ekipeve Shkollore për Parandalimin e Braktisjes dhe Reagimit ndaj Mosregjistrimit (EPBRM) të nxënësve.
- Filluar të përgatisim paramasat për projektin "Riparime në Shkolla", përkatësisht për riparimin e nyjeve sanitare dhe dysHEMEVE të shkollave dhe paramasën për ngrohje qendrore për shkollën "Dëshmorët e Lirisë" dhe për shkollën "Vëllezërit Frashëri" – paralelja e ndarë në Senoc.
- Në Shkollën e Mesme Profesionale kemi përruruar 3 kabinete: kabinetin e makinerisë, kabinetin e teknologjisë informative dhe kabinetin e shkencave juridike. Nëpër shkolla janë mbajtur programe festive për nder të 17 Shkurtit-Ditës së Pavarësisë së Kosovës, ndërkaq në bashkëpunim me DKRS kemi organizuar dhe mbajtur një tryezë diskutimi me historianë.
- Vazhdoi trajnimi me drejtorët e shkollave në kuadër të projektit "Shkollat e shek. 21", i mbështetur nga Këshilli Britanik, Masht dhe DKA. Kanë rifilluar punimet në ndërtimin e objektit të shkollës në Kaznik dhe në Fortesë. Kemi përgatitur kërkesat për mbështetje financiare të projekteve drejtuar MASHTI-t, dhe kemi marrë pjesë në Konferencën për Edukimin të organizuar nga Qendra për Arsim e Kosovës dhe nga Organizata "Teach for Kosova".
- Drejtori i DKA-së, më 9 Mars, ka marrë pjesë në takimin e thirrur nga MASHTI për të shqyrtuar situatën e krijuar nga përhapja e Virusit Corona dhe për masat parandaluese që duhet

ndërmarrë në çerdhe e shkolla. Pas këtij takimi, DKA ka themeluar një ekip koordinues për të ndërmarrë masat adekuate.

- Procesi mësimor në të gjitha nivelet e sistemit arsimor është ndërprerë, sipas vendimit të qeverisë dhe janë marrë masa në rritjen e higjienës në çerdhe e shkolla.

### Aktivitetet në periudhën prill – qershor

- Në këtë periudhë vizituam punishtet ku po punohet në realizimin e projekteve, si punishtet në ndërtimin e çerdhes në Xërxë, punimet në ndërtimin e objektit të shkollës në Fortesë dhe punimet në instalimin e ngrohjes qendrore në objektin e ri të shkollës në Hoçë të Vogël/Brestoc.
- Nisëm procedurat e prokurimit për projektin e renovimit në 10 shkolla dhe po ashtu projektin për instalimin e ngrohjes qendrore në shkollën “Dëshmorët e Lirisë” në Pataqan të Ulët dhe në paralelen e ndarë të shkollës “Vëllezërit Frashëri” në Senoc.
- Vazhduam me përcjelljen e procesit të mësimit në distancë duke zbatuar rekomandimet e MASHTIT-t për të gjitha nivelet e sistemit arsimor.
- Morëm njoftimin e rëndësishëm nga kompaia Consult-Eng – Prishtinë, e cila ka lidhur kontratë me MZHE-në, se do të fillojë së zbatuari projekti i zbatimit të masave të efijencës së energjisë në objektin e shkollës “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc.
- Nga ELKOS-Group dhe përmes MASHTIT kemi pranuar një donacion të vogël prej 11 laptopë të vegjël, të cilat i kemi shpërndarë tek nxënësit që nuk kanë pasur fare.
- Kemi pranuar raporte të rregullta nga drejtorët e shkollave për ecurinë e zhvillimit të mësimit nga distanca, me ç'rast kemi mbajtur edhe takime online me drejtorët e shkollave.
- Vazhdoi procesi i aplikimit të studentëve në konkursin për bursa komunale.
- Nisëm hartimin e paramasave për riparimin e tualeteve dhe nyjeve sanitare për 4 shkolla, të cilat pasi i përgatitëm, i kemi dërguar në Departamentin e Infrastrukturës në Ministrinë e Arsimit.
- Kemi përgatitur një raport detal të ecurisë së mësimit në distancë gjatë kësaj periudhe dhe këtë raport e kemi prezantuar në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal.
- Realizuar planifikimin për regjistrimin e nxënësve në klasat e 10-ta në 3 SHML-të dhe në SHMLP.
- Nga MASHTI morëm njoftimin se testi i arritshmërisë do të mbahet më 23 qershor dhe ai i maturës më 4 korrik. Po ashtu, nga MASHTI kemi marrë njoftimin se do të fillohet me mësim plotësues me nxënësit e klasave të nënta dhe të 12-a. Për këtë arsye mbajtëm një mbledhje me të gjithë drejtorët e shkollave fillore të mesme të ulëta për t'i bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme. Nga data 3 qershor rifilloi puna në objektin e vjetër të çerdhes së fëmijëve, pasi bëmë dezinfektimin dhe punët tjera përgatitore.
- Për mbajtjen e Testit të Arritshmërisë përcaktuam 5 qendra (objekte shkollore), të cilat u përgatiten për t'i pritur numrin e nxënësve deri në 200 nxënës, me masa mbrojtëse sipas rekomandimeve të Mashti-t.
- Në objektin e ri të çerdhes Tulipanët ka vazhduar pajisja me inventarin e nevojshëm, proces ky i cili po vazhdon, por ende nuk ka përfunduar.

- Në objektin e shkollës “Nesimi Elshani” në Nagavc ka filluar projekti i efijencës së energjisë, ku fillimisht ka filluar puna në instalimin e ndriçimit efijent e pastaj do të vazhdohet me instalimin e ngrohjes qendrore dhe punëve të tjera të parapara sipas projektit.
- Kemi përgatitur 6 kërkesa drejtuar MASHTI-t për mbështetje financiare të projekteve në vazhdim, ndërkohë që në bashkëpunim me DKRS kemi filluar përgatitjet për garën sportive virtuale me nxënës të lindur në vitin 2008, organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

### PËRFUNDIM

Drejtoria Komunale për Arsim gjatë gjithë kësaj periudhe ka qenë e përkushtuar në realizimin e planit vjetor të punës, në përcjelljen dhe realizimin e projekteve dhe gjithashtu edhe në përcjelljen e mbarëvajtjes së procesit edukativo – arsimor në të gjitha nivelet. Ky përkushtim do të vazhdojë edhe në gjysmën e dytë të vitit, gjithnjë në përputhje të plotë me planin vjetor të punës.

### DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planin e punës për vitin 2020. Në kuadër të drejtorisë së DEZHT-së, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar një mori aktivitete.

#### Aktivitetet në periudhën: janar- qershor

Gjatë kësaj periudhe raportuese të vitit 2020 është bërë regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2019 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2020, poashtu, gjatë fillimit të vitit 2020 është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2020 në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2020.

Në tremujorin e parë të vitit 2020 është bërë shtypja e aktvendimeve për të gjithë bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale ku në bazë të kësaj ne kemi arritur të kemi një rritje të konsiderueshme të të hyrave në taksa afariste komunale.

Është duke vazhduar regjistrimi dhe vlerësimi i aseteve komunale, janë shqyrtuar të gjitha kërkesat të parashtruara nga palët si dhe janë përfunduar edhe në sistemin elektronik SIK, poashtu kanë filluar të procedohen lëndët e përmbartuesi privat, të cilat janë dërguar gjatë vitit 2019.

Pas situatës së krijuar së fundmi nga pandemia e shfaqur COVID-19, Kuvendi Komunal Rahovec, me qëllim të krijimit të lehtësirave për bizneset e komunës sonë ka marrë këtë VENDIM: Të gjitha bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit, e që gjithsej janë 31, të cilët kanë kontratë për shfrytëzimin e objekteve komunale, lirohen nga pagesa e qirasë mujore për periudhën: (mars-maj 2020); Lirohen nga taksa komunale të gjitha bizneset që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në komunën e Rahovecit, të cilët aktualisht janë të ngarkuar me rregulloren aktuale për taksa komunale, (mars-maj 2020).

Nga ana e Kryetarit, z.Smajl Latifi janë nënshkruar dy marrëveshje të mirëkuptimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR). Sipas këtyre marrëveshjeve, MZHR bashkë me Komunën e Rahovecit do të financojnë dy projekte, konkretisht: projektin: "Renovimi i Stacionit të autobusëve dhe kabinave inovative" në vlerën: 100.000 euro, si dhe projektin: "Ndërtimi i rrugës në fshatin Zaqisht", në vlerën: 30.000 euro. Infrastruktura në përgjithësi dhe ajo rrugore në veçanti vazhdon të mbetet si njëri nga prioritetet tona investive. Me të tilla projekte e në bashkëpunim e bashkëfinancim me ministritë, vazhdojmë të punojmë për të mirën dhe zhvillimin e Rahovecit.

Nga ana e Kryetarit, z.Smajl Latifi, është formuar komisioni në përbërje prej 3 anëtarësh, komision ky i cili ka bërë vlerësimin e dëmeve në amvisëri, pas reshjeve që kapluan komunën e Rahovecit, komisioni pas përfundimit të punëve në terren, ka hartuar edhe një raport të detajuar lidhur me vlerën e dëmeve që janë shkaktuar në ekonominë familjare.

### Zyra e regjistrimit të bizneseve

Për periudhën janar – qershor 2020, në Zyrën e Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve (QKRB) janë të regjistruara në protokoll, biznese të reja dhe janë shqyrtuar gjithsej lëndët si në tabelën vijuese:

| Nr. | Përshkrimi                | Numri i Lëndëve |
|-----|---------------------------|-----------------|
| 1   | Biznese të reja           | 45              |
| 2   | Shuarje Biznesi           | 0               |
| 3   | Informatë Biznesi         | 32              |
| 4   | Ndryshim Biznesi          | 45              |
| 5   | Duplikat Certifikatë      | 0               |
| 6   | N .U. I Certifikatë       | 45              |
| 7   | Vërtetim                  | 0               |
| 8   | Konfirmim                 | 3               |
| 9   | Certifikatë me datë të re | 1               |
| 10  | Refuzim (Anulim)          | 0               |
|     | <b>Gjthsej:</b>           | <b>171</b>      |

Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt dhe është siç vijon:

|   |                                                                               |             |
|---|-------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| 1 | Të hyrat nga qiraja për periudhën janar - qershor 2020                        | 24,114.25 € |
| 2 | Saldoja e mbetur në qira për periudhën janar- qershor 2020                    | 33,401.37 € |
| 3 | Të hyrat nga taksa afariste komunale për periudhën janar - qershor 2020       | 34,404.54 € |
| 4 | Saldoja e mbetur në taksa afariste komunale për periudhën janar- qershor 2020 | 53,095.46€  |

|   |                                                                                 |    |
|---|---------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1 | Pëlqime pune për biznese për periudhën janar – qershor 2020                     | 21 |
| 2 | Pranimi dhe shqyrtimi i ankesave nga bizneset për periudhën janar- qershor 2020 | 0  |



**Ecuria e realizimit të projekteve kapitale**

- Po vazhdon ndërtimi i shtëpisë për të moshuar për qëndrim ditor mbi qytetin e Rahovecit, tek "Epopeja e UÇK-së", ku Komuna e Rahovecit do t'i jep jetë si investitor me vlerë të kontratës: 89,979.00 euro. Në këtë qendër parashihet të ketë një sallë kolektive për qëndrim dhe aktivitete, dhoma për të pushuar si dhe teracë, projekti tashmë është në fazën përfundimtare;
- Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në Komunën e Rahovecit – Ky projekt është duke vazhduar, kemi përfunduar me krijimin e tri shtigjeve të ecjes në fshatrat Dejnë, Drenoc si dhe në pikën turistike Zhdrellë, punimet kanë filluar edhe në fshatin Krushë e Madhe për ndërtimin e projektit të Shtegut të Ecjes, "LULET E MARSIT";
- Investime në infrastrukturë, në Zonën ekonomike - Më datë 22.06.2018, me vendim të Qeverisë së Kosovës është krijuar Zona Ekonomike me një hapësirë prej 35,84 ha, poashtu është bërë licencimi i zonës industriale nga ana e MTI-së, ka mbetur të bëhet fillimi i investimeve direkte në zonë, ku deri më tani ka përfunduar rrethimi i një pjese prej 1500m me mur mbrojtës si dhe pastrimi përreth kësaj zone.

**DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT**

Në fillim të vitit 2020, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ka publikuar planin vjetor të punës, në të cilën është bazuar edhe në punën e bërë në gjashtëmujorin e parë për të cilën do të raportohet në këtë raport pune për muajt; janar - qershor.

**Aktivitetet në periudhën: janar - qershor**

Pas miratimit të buxhetit për vitin 2020 nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, Drejtoria për Urbanizëm ka përgatitur materialin për shpalljen e procedurave të tenderimit publik për hartimin e projekteve të ndryshme të Komunës së Rahovecit, procedura momentalisht është në fazën e përfundimtare të lidhjes së kontratës.

Poashtu, janë pranuar detyra projektuese për projekte të reja në komunën e Rahovecit, siç janë: Qendra e Mjekësisë Familjare në Opterushë, Mbulimi i pllatores ku zhvillohet festivali "Anadrinia Jehon", shtigje të ecjes, renovimi i stacionit të autobusëve, rregullimi i shtretërve të përrunjve e projekte tjera me interes për qytetaret e komunës e Rahovecit.

Kanë vazhduar aktivitetet dhe takimet me kompanitë konsulente për hartimin e Planit Zhvillimor dhe Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit. Plani Zhvillimor është në prag të finalizimit, jemi në pritje të marrjes së pëlqimit nga Ministria Ekonomisë dhe Ambientit dhe të vazhdohet me procedurën e shqyrtimit publik dhe pastaj për aprovim në Kuvend, ndërkaq rreth hartimit të Hartës Zonale është pranuar drafti i parë i gjendjes ekzistuese dhe puna është duke vazhduar sipas planit të paraqitur në kontratë.



Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, plan mjedisor që është hartuar për herë të parë në Komunën e Rahovecit, pasi është dalë në shqyrtim publik me lejen e Kuvendit të Komunës së Rahovecit është miratuar në seancën e marsit të Kuvendit Komunal Rahovec.

Janë shënuar me aktivitete simbolike ditët ndërkombëtare mjedisore, dita e ujit, dita e tokës dhe dita botërore e mjedisit. Ne ditën botërore të mjedisit, me 5 qershor, janë shpallur fituesit e konkursit për oborrin më të rregulluar, rrugën më të pastër etj.

Procesi i trajtimit të objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit është duke vazhduar, janë pranuar kërkesa të shumta nga qytetarët për t'i legalizuar objektet e tyre, lëndët po shqyrtohen me kujdes, disa prej kërkesave janë futur në listën e pritjes për legalizim, pasi kështu është përcaktuar me ligjin për trajtimin e objekteve pa leje, pasi këto objekte janë të ndërtuara në tokë jo-ndërtimore apo për arsye tjera që përcaktojnë futjen në listën e pritjes, ndërkaq janë legalizuar objektet që i kanë plotësuar dhe i kanë përmbushur të gjitha kriteret për legalizim.

### **Ecuria e realizimit të projekteve kapitale**

- Bashkë me UN-Habitatin kemi vazhduar procesin e planifikimit dhe shpalljes së konkursit ndërkombëtar për hartimin e projektit ideor të sheshit qendror të qytetit në Rahovec. Sipas marrëveshjes që kemi lidhur me këtë organizatë të specializuar të Kombeve të Bashkuara, planifikuesit urban janë vendosur në zyrat e Drejtorisë së Urbanizimit dhe në bashkëpunim me ta kemi përfunduar një pjesë të konsiderueshme të punëve të parapara, janë përfunduar matjet gjeodezike, është formuar ekipi komunal për planifikim, me vendim të Kryetarit, janë mbledhur të dhëna të pjesës ku planifikohet të ndërtohet sheshi, janë marrë informata gjeodezike dhe kadastrale, janë shpallur disa pjesë me vendim të Kuvendit Komunal, në interes publik për ndërtimin e sheshit, është bërë plani për mbajtjen e diskutimeve publike në fund të marsit, mirëpo për shkak të masave të Qeverisë së Kosovës për mbrojtjen nga Virusi Corona, janë shtyrë në një afat të papërcaktuar diskutimet me qytetarë dhe si forme alternative për të marrë mendimet e qytetareve, në muajin qershor kemi publikuar një pyetësor online, në të cilën qytetarët kanë mundësi të japin mendimet dhe idetë e tyre rreth vizionimit të konkursit ndërkombëtar për dizajnimin e sheshit qendror të qytetit të Rahovecit.
- Projekti i ndërtimit të tetë parqeve në Komunën e Rahovecit ka vazhduar edhe në këtë gjashtëmuor, ka përfunduar ndërtimi i parkut në Sopniq, në Pataqan të Poshtëm, në Malësi të Vogël, në Dobidol, në Celinë dhe ndërtimi i oborrit të shtëpisë së fshatit në Senoc. Punimet po vazhdojnë në Zaqishtë do të vazhdohet edhe ndërtimi i parkut në Ratkoc.
- Ndërtimi i kullës prej guri për heronjtë Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi – Mici të vendi i rënies mbi fshatin Operushë, ka vazhduar ndërtimi i objektit, momentalisht po punohet në punët me gurë.
- Ndërtimi i shtatores për heroin Feim Gashi është përfunduar, është përfunduar edhe shkrirja në bronz, është planifikuar në prill të vendoset së bashku me shtatoren e heroit, vëllait të Feimit, Bedrush Gashi, në qendër të fshatit Drenoc, mirëpo për shkak të pandemisë, vendosja e shtatoreve është shtyrë në një afat të pacaktuar. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe

Mbrojtje të Mjedisit si menaxhuese e këtij projekti së bashku me operatorin e kontraktuar ekonomik do të jenë të gatshëm ta vendosin me kohë shtatoret për heronjtë Bedrush e Feim Gashi, si të krijohen mundësitë për organizime të tubime.

- Është shpallur tenderi për ndërtimin e varrezave të deshmorëve dhe martirëve në fshatin Celinë si dhe rregullimin e renovimin e të gjitha pllakave, përmendoreve, pllatove, rrethojave të vend rënieve në komunën e Rahovecit. Pas përfundimit të hartimit të projektit do të nisim procedurat publike për lidhjen e kontratës.
- Në grantin e performancës që ka fituar Komuna e Rahovecit, në buxhetin e ndarë për rregullimin e shtretërve të përrenjve në komunën e Rahovecit, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ka hartuar projektet për trajtimin e përroskave në Opterushë, Pataqan të Poshtëm, Malësi e Vogël dhe Polluzhë. Mënyerisht projekti është në procedurë të prokurimit publik.
- Ka përfunduar ndërtimi i lapidarit "Altari i Lirisë", kushtuar martirëve të fshatit Guri i Kuq. Lapidari është zbuluar më 14 qershor, në ditën e Çlirimit të Rahovecit.
- Është lidhur kontrata për mbjelljen e mbi 10 mijë drunjve në komunën e Rahovecit. Deri më tani nga kjo kontratë janë mbjellë rreth 3500 drunj, do të vazhdohet mbjellja e tyre sipas kohës optimale.
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve nga Hoça e Madhe deri në Krushë të Madhe ka vazhduar në tremujorin e dytë, në kohën kur ka filluar të përmirësohet moti. Punimet mënyerisht janë duke vazhduar në: Brestoc, Nagac dhe Krushë të Madhe.

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2020, përkundër sfidave dhe vështirësive ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktivitetsish përgjatë kësaj periudhe gjashtëmujore. Në vazhdim DSHP ka raportuar për aktivitetet kryesore që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

### Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Sipas planit të prokurimit të dorëzuar (Dhjetor 2019) dhe draftplanit të dorëzuar gjatë muajit shkurt 2020, DSHP ka filluar të respektojë datat e dhëna në planifikim, dhe ka përgatitur gjatë muajit janar, dy projekte:
  - a). Projektin për furnizim me gypa nga PVC;
  - b). Projektin për intervenime emergjente;
  - c). Projektin për investime dhe mirëmbajtje të hapësirave publike.
- Gjatë muajit janar, kemi lidhur kontratën me dy kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore;
- Është nënshkruar marrëveshje me UNDP për vazhdimin e projektit të rrjetit të kanalizimit në Kramovik, është përgatitur edhe projekti detaj;

- Kanë vazhduar punimet në projektet infrastrukturore, projekti i rrjetit të kanalizimit po vazhdon në fshatin Potoqan i Epërm, është përfunduar një segment i rrjetit të kanalizimit në rrugën "Agim", po vazhdon puna në kubëzimin e rrugëve në Xërxë dhe në Çifllak, në kuadër të projektit me zyrën komunale për komunitete;
- Në projektin e rrugës 4 korsi, Lot 3 ka filluar aktiviteti me piketimin e trasesë së rrugës, ku ka identifikuar pengesat;
- Kemi nënshkruar marrëveshje me IOM-in për programin projekte me bashkëfinancim;
- Kanë vazhduar punimet në projektet infrastrukturore, projekti i rrjetit të kanalizimit po vazhdon në Dobidol, sipas kontratës;
- Në muajin janar kanë vazhduar punimet në rrugën Xërxë-Sapniq-Ratkoc, është duke u bërë përgatitja e nënbazës me zhavorr dhe elemente të tjera përcjellëse;
- Në muajin janar kanë vazhduar punimet në ndërtimin e trotuarëve në Ratkoc;
- Është mbajtur një takim i grupit punues rreth tarifave komunale sipas rregullores së unifikuar nga departamentet ligjore të të gjithë komunave të Kosovës;
- Është mbajtur një takim i bordit të ndërmarrjes publike lokale në Stacion të Autobusëve lidhur me regjistrimin e ri të ndërmarrjes dhe hapat se si duhet të lirohet një pozitë e një anëtarit të bordit për shkak të procedurave;
- Është mbajtur një takim me përfaqësues të UNMIK-ut, lidhur me mbështetjen e projektit të kamerave në qytet, ky grand është i fituar dhe janë bërë matjet dhe piketimi i kamerave në qytet, nga UNOPS dhe UNMIKU;
- Gjatë kësaj periudhe ka pasur aktivitete në terren, ku tashmë zyrtarisht është lëshuar uji i pijshëm për fshatin Pastasel, punët nga ana e komunës janë përfunduar, mbetet tek KRU Gjakova- mirëmbajtja dhe furnizimi i rregullt;
- Gjatë muajit shkurt kemi mbajtur një takim me Kryeshefin ekzekutiv, duke diskutuar shumë çështje rreth projekteve, është dhënë pëlqim nga ana e komunës për investime në Xërxë, duke instaluar gypat e rinj të ujit të pijshëm;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike, përveç përgatitjes së disa projekteve në infrastrukturë publike, ka filluar shpalljen e procedurave të prokurimit për projektin investime dhe mirëmbajtja e hapësirave publike;
- Gjatë muajit Mars kanë vazhduar punimet në segmentin e rrugës Rahovec-Potoqan i Poshtëm;
- Po vazhdon ndërtimi i trotuarëve në Ratkoc dhe në Opterushë;
- Më 12 mars 2020, kemi përfunduar së bashku me zyrtarë të ujësjellësit ujin e pijshëm në Pastasel;
- Pas situatës së krijuar me virusin korona, gjatës muajit mars kemi angazhuar masa shtesë kundër virusit COVID-19, në pastrimin e qytetit dhe fshatrave, në larjen e rrugëve si dhe në heqjen e mbeturinave inerte.

#### Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor

- Gjatë muajit prill, janë përfunduar të gjitha lëndët në intranet, sipas afateve të dërguara në Drejtori:

- Kanë vazhduar punimet në projektet infrastrukturore, projekti i rrjetit të kanalizimit ka përfunduar në fshatin Dabidol, është përfunduar në fshatin Krushë e Madhe dy segmente, dy segmente janë përfunduar në Optrushë, po vazhdon në Fortesë e kështu me radhë;
- Kanë vazhduar punimet në rrugën Xërxë-Sapniq-Ratkoc, duke u bërë përgatitja e nën bazës me zhavorr dhe elementeve tjera përcjellëse;
- Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e rrugës Rahovec-Hamoc-Fortesë;
- Vazhdojnë punimet në ndërtimin e rrugës 4 korsi Rahovec-Xërxë, Loto 1, Loto 2 dhe Loto 3;
- Pas situatës së krijuar gjatës javës së shkuar kundër virusit COVID-19, se bashku me stafin e drejtorisë po përgatitemi ti përfilllemi rekomandimet e dalura nga shtabi emergjent në komunë, pas kësaj situatë janë marruar disa masa në drejtim të pastrimit të qytetit dhe fshatrave, në larjen e rrugëve si dhe në heqjen e mbeturinave të vëllimshme,
- Është bërë larja dhe dezinfektimi i rrugëve në qytet gjatë vikendit,
- Kanë vazhduar punimet në projektet infrastrukturore, po vazhdon shtrirja e rrjetit të ri të kanalizimit në fshatin Xërxë në lagjen "Kryeziu" dhe në lagjen "Hamza" në Rahovec,
- Në këtë periudhë kanë vazhduar punimet në ndërtimin e rrugës Rahovec-Hamoc-Fortesë, është duke u punuar në segmentin e dytë nga Rahoveci në drejtim të Brestocit, jemi në fazën e instalimit të infrastrukturës nëntokësore, në ndërtimin e mureve mbrojtëse, ujit të pijshëm, kanalizimit, etj.
- Kemi filluar me mirëmbajtjen e hapësirave publike në fshat dhe qytet, është dhënë rekomandim që deri me 23 maj të përfundojë faza e parë e pastrimit të të gjithë hapësirave publike;
- Po vazhdon ndriçimi publik, kemi filluar me Rahovec, me tre segmente në Krushë të Madhe, me 5 segmente në Malësi të Vogël dhe po ashtu do të vazhdojmë sipas planit të hartuar nga DSHP;
- Po ashtu jemi në fazën e përgatitjes së projektit të ndërtimit të rrugëve në tërë territorin e komunës së Rahovecit, përveç kësaj komuna e Rahovecit ka bërë aplikimin në thirrjet për grande në Infrastrukturë në tre projekte infrastrukturore;
- Janë duke vazhduar punimet në projektet infrastrukturore, po vazhdon shtrirja e rrjetit të ri të kanalizimit në fshatin Bratatin dhe në fshatin Ratkoc, është ndërprerë në fshatin Xërxë në lagje Kryeziu për shkak problemeve pronësore;
- Po ashtu jemi në fazën e përgatitjes së projektit të ndërtimit të rrugëve në tërë territorin e komunës së Rahovecit, përveç kësaj komuna e Rahovecit ka përfutur në dy grande në Infrastrukturë (në rregullimin e stacionit të autobusëve dhe infrastrukturës përcjellëse dhe rregullimin e rrugës në Zaqishtë);
- Është bërë rehabilitimi i rrugëve në qytet, janë asfaltuar dy segmente rrugore në qytet;
- Ka filluar puna në projektin krijimi i parkingjeve të reja në qytet, jemi duke vendosur gypin e ujit atmosferik në rrugën Gëzim Mullabazi si dhe është përfunduar puna;
- Ka pasur një telashe për çështjen e ujit të pijshëm në Patasel, është gjetur deformimi i gypit, ku shpresojmë që të punojnë KRU Gjakova në këtë drejtim që mos të kemi ankesa për ujë të pijshëm;
- Ka vazhduar puna në shpërndarjen e gypave nga PVC sipas kontratës;



- Po ashtu jemi në procedurë të detyrave projektuese për ndërtimin e kanalit të ujërave atmosferik në qytet, pas takimit që kemi mbajtur me inxhinier të komunës sonë, janë bërë matjet gjeodezike dhe shumë shpejt do të projektohet kanali për trajtimin e ujërave në qytet;
- Parapërgatitje për KAB-in komunal (drafti i parë), si dhe kemi dërguar në qeveri të Kosovës një mori kërkesash drejtuar Ministrive të linjës për mbështetje financiare të projekteve aktuale dhe projekteve të reja;
- Sa i përket kërkesave të shumta që kanë ardhur në Drejtorinë e Sherbimeve Publike, nga 1 janari 2020 deri me 20 qershor 2020, ne DSHP janë adresuar 203 kërkesa të ndryshme që kanë të bëjnë me; qështje publike komunale, objektet e përkohshme dhe shfrytëzim i hapësirës publike si dhe kërkesa tjera nga qytetarët. Prej gjithsej 203 kërkesave 146 janë miratuar, 18 janë refuzuar, 34 janë në proces si dhe 4 janë pranuar si të ceduara nga drejtoritë.

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

### HYRJE

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2019, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vehte aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve, i ndarë në periudha tremujore.

### Aktivitetet në periudhën: janar - qershor

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuara sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranim i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019 për fermerët blegtor ( MBPZHR hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë kjo thirrje ka qenë e hapur nga: 15 janar deri më 15 shkurt).
- DBPZHR ka ndërmarr masat dhe është përgatitur me kohë për hapjen e thirrjeve nga MBPZHR për pagesa direkte (jemi kujdesur që të furnizohemi me material administrativ për të përballuar fluksin e madh të fermerëve),

- Sikurse vitin e kaluar, kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softverët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkohen nga MBPZHR. Poashtu leje e veçantë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për mundësinë e nxerrjes së dokumenteve të pronësisë edhe në këto dy qendra. E gjithë kjo me të vetmin qëllim për të ju lehtësuar fermerëve të komunës sonë këtë proces.
- Poashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 7 zyrtarë të rinjë me kontratë për punë specifike të cilët janë trajnuar dhe aftësuar për përdorim të programit të Ministrisë gjatë procesit të aplikimit dhe digjitalizimi i parcelave),
- Si vazhdimësi e projektit për përkrahje të fermerëve me mekanizëm bujqësor, në muajt janar dhe shkurt janë shpërndarë pajisje për fermerët përfitues me të cilët kemi lidhur kontratë. Poashtu është bërë verifikimi i mekanizmave bujqësor të shpërndarë nga komuna jonë, duke u bazuar në vendimin AD-HOCK të Kryetarit të Komunës
- Komisioni i caktuar nga kryetari për përzgjedhje të fermerëve përfitues të serrave për vitin 2019, publikimi i raportit me emra të fermerëve përfitues si dhe fillimi i ndërtimit të serrave duke lidhur kontratat me fermerë dhe duke pranuar participimin prej 20% të vlerës.
- Gjatë muajit shkurt si pasojë e erërave të forta janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në serra. Komisioni ka dalë në terren për evidentimin e dëmeve të shkaktuar duke u bazuar në kërkesat e fermerëve, ka përpiluar procesverbal për secilin fermer dhe ka hartuar raport përfundimtar të cilin e kemi dërguar në Ministrinë e BPZHR-së së bashku me kërkesën për dëmshpërblim të fermerëve.

Tabela 1. Vlera e dëmeve të shkaktuara në serra nga erërat e fuqishme

| Nr. | Kultura                        | Sipërfaqe e dëmtuar | Vlera       |
|-----|--------------------------------|---------------------|-------------|
| 1   | Serra me sipërfaqe të ndryshme | 2,89 ha             | 71,863.89 € |

- Fermerët tanë në fund të marsit dhe fillim të prillit janë ballafaquar me temperaturat të ulëta dhe ngrica, ku si pasojë e kësaj janë dëmtuar shumë kultura perimtare me theks të veçantë në patate dhe kunguj. Komisioni i formuar me vendim të kryetarit ka dalur në terren dhe ka bërë vlerësimin e dëmit të përmbledhur në raport detal për secilin fermer.

Tabela 2. Vlera e dëmeve të shkaktuara nga ngricat pranverore

| Nr. | Kultura         | Sipërfaqe e dëmtuar | Vlera               |
|-----|-----------------|---------------------|---------------------|
| 1   | Patate          | 117.18 ha           | 197,741.41 €        |
| 2   | Kunguj          | 2.37 ha             | 4,740.00 €          |
|     | <b>Gjithsej</b> | <b>119,55 ha</b>    | <b>202,481.41 €</b> |

- Në bashkëpunim me shoqatën e bletarëve është mbajtur trajnimi për fermerë bletarë të komunës sonë, në këtë trajnim bletarët e komunës sonë u njohën për së afërmi për zgjidhjen e problemeve që shkaktohen te bletët.
- Poashtu në bashkëpunim me kompaninë ALMAKO-QFPB është organizuar trajnim për blegtorët e komunës së Rahovecit me ekspert nga Austria të kësaj fushe. Temë e trajnimit ishte "Menaxhimi i Silazhit dhe standardet e BE-së për ndërtimin e stalave të gjedhit"
- Nga mesi i muajit mars kur është shfaqur pandemia COVID-19, është ndaluar edhe lvizja e fermerëve për të kryer aktivitetet e nevojshme në fermat e tyre. Ne si drejtori kemi bërë të vazhueshme që fermereët tanë të lejohen të lëvizin. Mbi bazën e kësaj kemi kërkuar nga Qeveria e vendit që asesi fermerëve të mos iu ndalohej lëvizja. Kërkesa jonë është aprovuar dhe gjatë kësaj periudhe i kemi pajisur të gjithë fermeret me dokumente të nevojshme (NIF) siç është kërkuar nga MBPZHR-ja.
- Në bashkëpunim me organizatën IADK me të cilën kemi të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të projektit për të Ri-atdhesuarve kemi bashkëfinancuar 6 fermerë përfitues në mekanizëm bujqësor.
- Kemi zhvilluar procedurat në bashkëpunim me zyrën e prokurimit për shpallje të tenderit për: Konsulencë dhe Hartim i projekteve për fermer, është lidhur kontrata dhe jemi në pritje të hapjes së thirrjes për grante nga MBPZHR.
- Në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës Nr.712//72, 713/72, 714/72 dhe 715/72 Komisioni për vlerësimin e dëmeve në bujqësi të shkaktuara nga breshëri dhe shirat e rrëmbyeshëm me datë 19 dhe 20 Maj 2020. Komisioni ka bërë mbledhjen e të dhënave në terren dhe ka përgatitur raport detal i cili është dorëzuar në MBPZHR së bashku me kërkesën për dëmshpërblim për fermerët.

Tabela 3. Vlera e dëmeve të shkaktuara si dhe sipërfaqet e dëmtuara.

| Nr.   | Kultura       | Sipërfaqe e dëmtuar | Rendiment i dëmtuar në kg | Vlera në €     |
|-------|---------------|---------------------|---------------------------|----------------|
| 1     | Perimekulturë | 233.55              | 6,483,100                 | 1,636,989.00 € |
| 2     | Lavërtari     | 150.08              | 444,512                   | 102,346.08 €   |
| 3     | Vreshtari     | 368.84              | 2,767,124                 | 890,454.00 €   |
| 4     | Pemëtari      | 4.20                | 28,772                    | 11,311.80 €    |
| TOTAL |               | 756.67              |                           | 2,641,100.88 € |

- Zyrtarët e DBPZHR-së gjatë kohës së pandemisë kanë qenë vazhdimisht në terren duke vizituar fermerët dhe duke kërkuar nga ata që ti respektojnë rekomandimet e IKSHPK-së. Përveç kësaj janë grumbulluar të dhëna mbi humbjet që iu janë krijuar fermerëve si shkak i mungesës së tregut në kohën e pandemisë për shitjen e produkteve të gatshme.
- Duke pasur parasysh nevojën për shitjen e produkteve të gatshme të prodhuara nga fermerët tanë, kemi bërë kërkesë të vazhdueshme për hapjen dhe funksionalizimin e tregut të gjelbërt, ku kemi dërguar kërkesë zyrtare në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Poashtu kemi hartuar planin

operativ për mbarëvajtjen e shitjes së produkteve duke iu përmbajtur në përpikshmëri rekomandimeve të IKSHPK-së.

- Për humbjet që iu janë shkaktuar fermerëve tanë si pasojë e pandemisë COVID-19, kemi adresuar kërkesë zyrtare Qeverisë së Republikës së Kosovës për përfshirje të fermerëve në Pakon Emergjente Fiskale
- Janë inicuar procedurat e prokurimit për shpallje të tenderit për projektin " Ndërtimi i serrave me participim 80%-20%"
- Pranimi dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si kërkesa për marje të tokës bujqësore në shfrytëzim, pagesat e qeras së tokave bujqësore komunale dhe kërkesa për ndërrim-destinimi të tokave bujqësore në ato ndërtimore
- Shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: Vërtetim për fermer, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë.

## Projektet e investimeve kapitale

Qysh në fillim të vitit kanë rifilluar punimet në projektet ku kemi kontratë me Operatorët Ekonomik.

- Ka vazhduar ndërtimi i serave të pa përfunduara pas shpalljes së rezultateve nga komisioni, duke përmbushur kontratën aktive në kuadër të kësaj kontrate janë ndërtuar 15 serra 3 ari dhe 11 serra 5 ari.
- Në projektin "Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit" kanë vazhduar punimet e fazës së dytë, kryesisht është bërë ndërtimi i shtëpizave (tezgëve) prej druri në pjesën e poshtme dhe përgjatë rrugës që shërbejnë për ekspozim dhe shitje të produkteve bujqësore. Ndërkohë do të vendosen edhe ulëset dhe do të bëhet mbulimi i trafave elektirke me dru si dhe mbjellja e drunjëve dekorativ.

Projekti për rregullimin e rrugëve fushore ka vazhduar dhe është punuar në të tri lotet, kryesisht në fshatrat:

- Lot 1: Dejnë, Vrajkë, Ratkoc, Malësi e Vogël
- Lot 2: Rahovec, Senoc, Pastasel, Drenoc, Kaznik, Polluzhë, Nushpallë, dhe
- Lot 3: Hoçë e Vogël, Brestoc, Nagac.

Gjatë kësaj periudhe nuk kanë mbetur anash as projektet e trajtimit të kanaleve të kullimit, kryesisht është punuar në dy projekte, Kanali i kullimit të tokave bujqësore ne fshatrat Malësi e vogël, Ratkoc si dhe projekti i kullimit të tokave bujqësore në Xërxë.

## Sektori i Pylltarisë



Edhe sektori i pylltarisë kishte aktivitetet e planifikuara gjatë kësaj periudhe raportuese. Qysh në fillim është hartuar plani operativ për pyllëzimin e sipërfaqeve të reja. Ky plan parasheh të mbillen 20 ha me pyje të reja të llojeve: Pishë e Zezë, Bung dhe Dushk.

Sikurse sektorët e tjerë edhe ky sektor e pësoi nga pandemia COVID-19. Pikërisht në kohën e ndalesave qytetarët vërshuan malet për të kaluar kohën ku kanë ndezur zjarre dhe nga pakujdesia e tyre janë përfshirë shumë sipërfaqe me zjarr në pyje, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme dhe duke djegur mbi 250 ha me pyje të ulëta.

Në këtë periudhë rojet e pyjeve ishin mjaft aktiv në mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve, duke kryer detyrën ndaj keqbërësve dhe prerësve ilegal të drunjëve ku në bazë të kësaj janë lëshuar 12 fletëparaqitje në gjykatë dhe janë realizuar 8 raste gjyqësore.

## PËRFUNDIM

*Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.*

*Duke u bazuar në planin e punës kemi devijim nga ajo çka ne kemi planifikuar pasi që periudha e parë që përfshinë muajt janar, shkurt dhe mars kemi paraparë që të zhvillohet procesi i aplikimit për pagesa direkte-subvencione në kuadër të MBPZHR-se, dihet që akoma nuk është hapur thirrja dhe për këtë arsye kemi mospërmblidhje të planit të punës me raportin për këtë periudhë.*

*Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm. Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në terren duke takuar fermer në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre. Poashtu nga fermerët kemi marr informata për pajisjet që iu nevoiten atyre, ku ne do të i përfshijm në thirrjet për aplikim që do të hapen në gjashtëmujorin e dytë.*

*Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe të pandemisë stafi i DBPZHR ishte i reduktuar, mirëpo kjo nuk ka ndikuar që fermerët tanë të ngecin në marrjen e shërbimeve të nevojshme në drejtorinë tonë.*

*Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionist të fushave, me theks të veçantë inxhinier të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohemi dhe të zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.*

## DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

### Aktivitetet në periudhën: janar- qershor

Fillimi i vitit të ri është karakterizuar me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak. Qysh në fillim të vitit 2020 i jemi qasur punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për vitin 2020.

Gjatë periudhës tre mujore për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

| Spektori:          | Lëndët:              | Shuma €         |
|--------------------|----------------------|-----------------|
| Kadastër dhe Pronë | 302                  | 5,117 €         |
| Gjeodezi           | 1630                 | 4,910 €         |
| Referenti          | 1,960+52 L.Z.        | 5,970 €         |
| <b>Totali</b>      | <b>3,892+52 L.Z.</b> | <b>15,997 €</b> |

- Kemi përgatitur material të nevojshëm për mbledhjen e Kuvendit Komunal i cili është mbajtur me datën 26 Janar 2020 në të cilën kemi shpallur interes të përgjithshëm në Z.K. Rahovec dhe në Z.K. Xërxë për hapje të rrugës publike;
- Me kërkesë zyrtare të Inspektoratit kemi dalë në tereRn dhe kemi inçizuar gjendjen në Z.K. Çifllak me të cilën është konstatuar uzurpim të pronës publike, janë nxjerrë vendimet dhe është kërkuar nga uzurpatori që ta lirojë pronën publike;
- Me kërkesë të Drejtorisë për Ekonomi kemi nxjerrë historiatin e parcelës për Zonën Ekonomike dhe e njëjta i është dërguar Ministrisë përkatëse për kompletimin e lëndës;
- Avokati i komunës me kërkesë zyrtare ka aplikuar për ekzekutimin e vendimit të Kuvendit Komunal në lidhje me këmbimin e pronës ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Agjensionit Pyjor të Kosovës në sipërfaqe prej 60 ari në Z.K. Opterushë për ndërtimin e Kullës së Gurit në vend rënien e heronjve të Kosovës "Toni e Mici" me bashkëluftëtarë;
- Eshtë mbajtur trajnimi i punëtorve nga AKK në Prishtinë në lidhje me pranimin e lëndëve nga Drejtoria e Urbanizmit në lidhje me legalizimin e objekteve pa leje dhe regjistrimi i tyre në librat kadastral, ky proces ka përfunduar dhe tashmë lëndë po pranohen dhe po regjistrohen;
- Përgjigje me shkrim në lidhje me kërkesat e Avokatit të Komunës në lidhje me lëndë që janë në proces në gjykata.
- Me kërkesë zyrtare të Drejtorisë së Bujqësisë kemi përfunduar nxjerrjen e koordinatave për rrugë fushore për disa zona kadastrale në nivel Komune;
- Me kërkesë zyrtare të Inspektoratit kemi dalë në terren në lidhje me vërtetimin e pretendimeve për uzurpim të pronës publike në tre zona kadastrale në Opterushë, Brestoc dhe në Krushë të Madhe;
- Takim pune në lidhje për harmonizimin e Rregullores Komunale dhe Udhëzimeve Administrative të AKK-së që lidhen direkt me shërbime- produkte që ofron drejtoria jonë;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së palve në lidhje me faljen e pronës private për hapje të rrugës dhe përkthimi në pronë publike në Z.K. Rahovec;
- Trajnimi dhe rilicencimi i punëtorve nga AKK-ja në lidhje me ofrimin e shërbimeve edhe në dy zona kadastrale në Ratkoc dhe në Krushë të Madhe në kohën e aplikimeve për subvencione bujqësore;
- Nxjerja e aktvendimeve për uzurpim të pronës publike.

- Me kërkesë zyrtare të Këshillit të Fshatit Malësi e Vogël kemi dalë në terren kemi kufizuar parcelën e cila po destinohet për interes të përgjithshëm publik për nevojat e fshatit;
- Inçizimi i rrugës publike nga rrethi në hyrje të qytetit në drejtim të rrugës tranzite Rahovec-Malishevë në anën e djathtë të rrugës ku është planifikuar të zgjerohet edhe me një shirit, dhe inçizimi i rrugës Rahovec-Xërxë të dy anë të rrugës sipas projektit të rrugës për katër korsi ku sipas inçizimit ka rezultuar me uzurpim të pronës publike në zonën kadastrale në Bërnjak dhe në Fortesë;
- Me kërkesë zyrtare të Drejtorisë së Arsimit kemi përfunduar dokumentacionin e kërkuar për 7 zona kadastrale në lidhje me situacionin e terrenit, certifikatat e pronës dhe kopje plani për shkolla dhe çerdhet publike;
- Pas inçizimit të gjendjes faktike në teren në katër zona kadastrale Rahovec, Bërnjak, Fortesë dhe Xërxë për gjatë rrugës Rahovec- Xërxë janë evidentuar uzurpime të pronës publike dhe janë nxjerr Aktvendime për uzurpim dhe i janë dorëzuar palëve sipas ligjeve në fuqi;
- Me kërkesë zyrtare nga Drejtoria e Shërbimeve Publike kemi nxjerrë koordinata dhe kemi kufizuar shtatë parcela në rrugën që është në ndërtim e sipër Rahovec, Hamoc dhe Fortesë;
- Me punëtor të IT-së i kemi funksionalizuar edhe dy zyrat mobile në dy zona kadastrale në ZK Krushë e Madhe dhe Ratkoc për aplikimin e subvencioneve bujqësore;
- Me kërkesë zyrtare nga inspektorati kemi dalë në terren në disa zona kadastrale për vërtetim të pronës publike;
- Me kërkesë nga kryetari i fshatit Celinë kemi përgatitur situacion terreni, kopje plani dhe certifikatën e pronësisë në lidhje me varrezat e martirëve;
- Përgjigje në kërkesat e Drejtorisë së Bujqësisë në lidhje me ofrimin e koordinatave të rrugëve në shumë zona në nivel komune për kufizim dhe shtrim të rrugëve fushore me zhavorr;
- Kufizimi i parcelës ku po ndërtohet Shfmu "Sadedin Hajda" në Rahovec me kërkesë të Drejtorisë së Arsimit;
- Me kërkesë nga komisioni për rrënimin e objekteve pa leje kemi nxjerr historiate, kopje plani dhe certifikata të pronësisë në disa zona kadastrale në nivel komune;
- Me kërkesë të DKRS-së, kemi përgatitur materialin e nevojshëm si: situacione të terrenit, kopje plani dhe certifikata në të gjitha vendpunishtet në nivel komune.

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin drejtoria janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xërxë, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, së bashku me nëndegët e saj në Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe.
- Stadiumin "Jahja Danuza" në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën "Mizahir Isma".

Përveç buxhetit të caktuar komunal, DKRS ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes bashkëpunimit me OJQ-të, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

### Aktivitetet e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport:

Përgjatë këtij gjashtëmuji të parë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përfunduar aktivitete të planifikuara në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve, duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të Komunës së Rahovecit.

Në raportin e punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.

Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.

Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

### Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në qershor të vitit 2020. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

### Aktivitetet e DKRS-së për periudhën raportuese të gjashtëmuji të parë të 2020 janë:

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2020, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, janë realizuar shumë takime me partnerë dhe palë të jashtme, ku jemi përkushtuar maksimalisht në arritjen e objektivave në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbyllur planin e punës, qëllimet dhe arritjen e objektivave për këtë periudhë kohore.

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2020;
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-së nga viti paraprak;
- Përgatitja e planit të prokurimit për projekte kapitale.



Për nder të manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor "Flaka e Janarit", është formuar Këshilli Organizues, nga i cili janë planifikuar organizimi i këtyre aktiviteteve:

- Shpallja e Konkursit Letrar "Pena e Flakës së Janarit".
- Homazhe dhe nderime për dëshmorët e kombit (Fortesë, Brestoc, Ratkoc),
- Ekspozitë në Galerinë e arteve, në bashkëpunim me OJQ Art Studio,
- Manifestimi qendror përkujtimor e kulturor "Flaka e Janarit" në Qendrën e Kulturore "Mensur Zyberaj" në Rahovec, si dhe promovimi i monografisë për dëshmorin Nesimi Elshani, nga autori Qemajl Krasniqi.

Poashtu, gjatë kësaj periudhe janë përfunduar edhe këto punë:

- Përgatitja e specifikacionit të thirrjes publike për subvencionimin e OJV-ve;
- Plotësimi i formularit të performancës komunale për kulturë, sport dhe rini;
- Është mbajtur Ceremonia e shpalljes së Sportistit më të mirë për vitin 2019.

Për nder të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, janë organizuar një varg manifestimesh kulturore-artistike dhe sportive:

- Formimi i Këshillit Organizues për nder të Ditës së Republikës së Kosovës, 17 shkurt.
- Shpallja e njoftimit për regjistrimin e ekipeve, për garat e organizuara për nder të 17 Shkurtit.
- Organizimi i garave sportive me fëmijët e Shkollave të Futbollit që veprojnë në Komunën e Rahovecit. (gara janë zhvilluar mes fëmijëve të lindur në ditën e shpalljes së pavarësisë).
- Tryezë diskutimi me Historian me temën "Arsimi shqip në Kosovë gjatë viteve të 90-të".
- Javë sportive në futboll të vogël, homazhe në të gjitha vendlësit, seancë solemne si dhe programi qendror - festiv (Qendra e Kulturës "Mensur Zyberaj", Rahovec);
- Për nder të "Javës së Dëshmorëve", është organizuar një ekspozitë virtuale "ART VIZUEL", e cila ka shprehur kreativitetin e artistëve dhe artdashësve nëpërmjet punimeve të ndryshme në pikturë, skulpturë, grafikë dhe fotografi me motive kombëtare;
- Po ashtu për nder të "Javës së Dëshmorëve" është organizuar edhe një akademi përkujtimore;
- Është organizuar edhe ekspozita virtuale "Atyre që vetëm lindje kanë", me fotografi të dëshmorëve të Komunës sonë;
- Dita e Qendrës së Shtëpisë së Kulturës– është përgatitur një reportazh me aktivitete të ndryshme kulturore, në pamundësi të mbajtjes së tyre sikur viteve paraprake për shkak të pandemisë COVID-19;
- Për nder të 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Rahovecit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përcjellur dhe organizuar aktivitete përkujtimore, në bashkëpunim me OVL-UÇK. Poashtu, është përgatitur "Orë poetike letrare" me poetë nga komuna e Rahovecit

si dhe një aktivitet me fëmijë të grupmohave të ndryshme "Art në Natyrë", ku fëmijët pikturuan punime të ndryshme.

## PROJEKTET KAPITALE

- Përgatitja e specifikacionit për tenderin "Furnizim i bibliotekave me libra" për bibliotekën e qytetit "Sulejman Krasniqi" me nëndegë;
- Përgatitja e specifikacionit për tenderin "Furnizim me flamuj, kurora, buqeta lulesh për aktivitete përkujtimore;
- Vazhdimi i punimeve, në kuadër të projektit "Restaurimi i monumenteve kulturore – historike" të projekteve rreth trashëgimisë kulturore, kujdesi për objektet në listën e mbrojtës së trashëgimisë kulturore dhe caktimi në listë të atyre që duhet të ruhen, evidentimi dhe përkufizimi i vlerave kulturore e historike të objekteve të trashëgimisë kulturore. Në kuadër të këtij projekti, kanë vazhduar punimet edhe në Bunarin e Madh në Ratkoc dhe në vende tjera duke u bazuar në plan programin e drejtorisë;
- Ka filluar projekti "Ndërtimi i infrastrukturës kulturore në fshatin Dejnë". Projekti përfshin ndërtimin e skenës, si dhe investim tjera në infrastrukturë kulturore;
- Ka vazhduar kontrata mbi projektin "Mirëmbajtja dhe pastrimi i palestrës sportive" me kompaninë "MSS Mobile";
- Në implementim e sipër vazhdon të jetë edhe projekti "Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në Ratkoc". Në kuadër të shtëpisë së Kulturës, funksionale do jetë edhe biblioteka e fshatit e cila do të ketë edhe sallën e leximit që do të shërbejë për të rinjtë e këtij fshati;
- Projekti "Rregullimi i terreneve sportive" vazhdon edhe përgjatë këtij viti. Kanë filluar punimet për ndërtimin e fushës sportive në Dejnë, kurse në Opterushë dhe Kramovik kanë filluar punimet gjatë muajit qershor;
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport po ashtu i ka adresuar MKRS-së disa kërkesa, për bashkëpunim në investim të disa projekteve:
  - Ndërtimi i Qendrës Multifunksionale në Rahovec,
  - Ndërtimi i Kompleksit Sportiv në zonën turistike në Rahovec,
  - Ndërtimi i fushave sportive në Opterushë, Kramovik, Nagavc, Reti e Poshtme dhe Fortesë,
  - Renovimi i stadiumit të futbollit në Rahovec,
  - Ndërtimi i palestrës në Krushë të Madhe,
  - Rregullimi i stadiumit të futbollit në Ratkoc.

## Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi"

- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

Gjatë kësaj periudhe, kemi bashkëpunuar me dashamirë të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtarë të komunës sonë, në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexueshmërisë.

Poashtu, kemi bashkëpunim të mirë me Bibliotekën Kombëtare, Bibliotekën Universitare, Bibliotekën Regjionale "Ibrahim Rugova"- Gjakovë, Bibliotekën "Hivzi Sylejmani"- Prishtinë, Bibliotekën e Prizrenit etj.

Falë bashkëpunimit të mirë që kemi krijuar me institucione kulturore, biblioteka jonë është pasuruar me tituj të rinjë librash.

Deputeti i Kosovës Rexhep Hoti i dhuroi Bibliotekës 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) ekzemplarë.

- Pasurimi i fondit librar: 531 ekzemplar Janar-Mars
- Fondi total i librave në bibliotekë: 17675 ekzemplar.
- Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar: 122 përdorues.

### Antarësimi në bibliotekë për periudhën: janar-qershor

| Periudha       | Anëtarë | Me pagesë | Gratis | Libra të lexuar | Djem | Vajza |
|----------------|---------|-----------|--------|-----------------|------|-------|
| Janar- Qershor | 297     | 292       | 7      | 1847            | 699  | 1148  |

### Tabela e lexuesve për periudhën: janar - qershor

| Sh.Fillore | Sh.Mesme | Student | Të tjerë | Djem | Vajza | Gjithsej |
|------------|----------|---------|----------|------|-------|----------|
| 215        | 49       | 13      | 20       | 108  | 189   | 297      |

### Palestra e sportit "Mizahir Isma" dhe aktivitete të tjera sportive

Gjatë gjashtë muorit të parë, në palestër janë realizuar aktivitete të shumta sportive, si nga klube të Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtare, ndër aktivitete tjera janë:

- Kombëtarja e Kosovës ka zhvilluar dy ndeshje në Hendboll me Kombëtarën e Kuwaitit "Kosova vs Kuwaiti";
- Ndeshjet e Superligës 2020, janë zhvilluar në Palestrën "Mizahir Isma";
- KB-Ferronikeli ka zhvilluar dy (2) ndeshje në Superlige dhe një (1) ndeshje për Kupën e Kosovës;
- Kupa e Kosovës në Basketboll, organizim nga KB Rahoveci, në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit dhe ofrimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme nga Komuna e Rahovecit;
- Përpos këtyre ndeshjeve, janë zhvilluar ndeshje nga klube tjera të Komunës së Rahovecit, si dhe aktivitete tjera të përditshme, të cilat mbahen në palestër;
- Poashtu, ka vazhduar mirëmbajtja e palestrës, në kuadër të kontratës për "Mirëmbajtjen dhe pastrimin e Palestrës Sportive "Mizahir Isma".

**Vërejtje:** Nga data 16.03.2020 deri më 05.06.2020 janë ndërprerë të gjitha aktivitetet në palestër, për shkak të pandemisë COVID-19, mirëpo stafi i punëtorëve kanë vazhduar punën dhe mirëmbajtjen e objektit të palestrës me orar dhe staf të reduktuar.

### Zyra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e monumenteve kulturore

Gjatë kësaj periudhe, në kuadër të Zyrës për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e monumenteve janë ndërmarrë këto veprime:

#### Dokumentet e hartuara:

- I. Është hartuar planprogrami gjashtë (6) mujor, i cili përfshin aktivitetet dhe objektivat në sektorin e trashëgimisë;
- II. Në bazë të planprogramit është përpiluar dhe plotësuar: Inventarizimi i Objekteve të Trashëgimisë Kulturore-Historike në Komunën e Rahovecit;
- III. Në kuadër të planprogramit dhe duke iu përshtatur kohës së pandemisë është publikuar ftesa për fotografi drejtuar qytetarëve të komunës së Rahovecit, për dërgimin e fotografive në të cilat paraqitet trashëgimia kulturore, natyrore etj;
- IV. Thirrja publike (e papublikuar), e cila ka të bëjë me kërkesën e zyrës, drejtuar qytetarëve të cilët posedojnë artefakte të cilat do të mund ta pasuronin muzeun;
- V. Gjithashtu është përgatitur struktura dhe përmbajtja për formimin e "Klubit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore-Natyrore", por për shkak të pandemisë implementimi i këtij klubi nuk ka qenë i mundur të realizohet, me arsyetimin se klubi pjesën më të madhe përbëhet nga nxënësit e shkollave të mesme të komunës së Rahovecit;
- VI. Hartimi i projektit lidhur me dixhitalizimin e trashëgimisë kulturore, projekti është paraparë në bashkëpunim me OJQ-në TIKA;
- VII. Njoftim lidhur me rifillimin e punës, në mbështetje të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë, në kuadër të fazave të vlerësimit;
- VIII. Në kuadër të thirrjes për aplikim nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është përpiluar projekti "Guida e Komunës së Rahovecit".

**Vëmendje:** Gjatë këtij gjashtëmujori janë ndërmarrë veprime të tjera të cilat nuk janë të listuara në raport, janë diskutuar dhe komentuar aktivitetet dhe ide të ndryshme, të cilat i përkasin sektorit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Gjithashtu, janë diskutuar disa nga aktivitetet e planifikuara në kuadër të planprogramit gjashtëmujor (6) të Zyrës për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e monumenteve trashëgimore, poashtu në aktivitete rinore dhe sportive, mirëpo për shkak të pandemisë janë pezulluar për një kohë pjesa dërrmuese e aktivitetëve dhe punës së drejtorisë, të cilat janë paraparë me planprogramin e punës. Përgjatë angazhimeve ditore gjithnjë përpiqemi që aktivitetet dhe puna të mos ndalet e që bëjmë përpjekje që aktivitetet tona të përditshme të përputhen me rregullat dhe masat e vendosura lidhur me pandeminë.



**DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE**

Në bazë të planit vjetor të punës për vitin kalendarik 2020, sipas dinamikës së punëve DPI ka zbatuar të gjitha ligjet përkatëse, sipas specifikave të lëmive të inspektorëve: tregtisë, sanitarisë, veterinarisë, ndërtimtarisë, pro|hësisë, komunikacionit dhe të mjedisit, për këtë periudhë rap|rtuese.

**Aktivitetet në periudhën: janar- qershor****INSPEKTORI I TREGUT**

*Gjatë periudhës janar-qershor, inspektorët e tregut kanë kryer:*

| Inspektime | Aktvendime | Pëlqime Pune | Fletëparaqitje |
|------------|------------|--------------|----------------|
| 250        | 37         | 26           | 1              |

Pas pranimit të telefonatës nga ana e Stacionit Policor në Rahovec, në lidhje me djegjen e gomave mbi fshatin Hoçë e Madhe, kemi dalur në vendin e ngjarjes ku është sanuar zjarri, së bashku me Ins. e mjedisit, Ins. e ndërtimit dhe Ins. e bujqësisë kemi inspektuar vendet ku zhvillohet aktiviteti ekonomik-shitja e automjeteve të demoluara, si dhe hekurishteve në fshatrat Xërxe dhe Fortesë, poashtu me asistimin e Stacionit Policor në Rahovec kemi vazhduar inspektimin e hekurishtave në qytetin e Rahovecit. Gjatë muajit shkurt, së bashku me insp. sanitar janë inspektuar furrat, ku nga ta është kërkuar verifikimi periodik i peshoreve, gramazha e bukës etj.

Krahas prioriteteve siç janë: eliminimi i konkurrencës së padrejtë tregtare, mbrojtja e hapësirave publike, krijimi i një mjedisi të pastër, parandalimi i ndërtimeve ilegale, informimi i qytetarëve për domosdoshmërinë e pajisjes me leje të ndryshme që lëshohen nga komuna, e prioriteti dhe fokusi ynë kryesor ka qenë mbrojtja e shëndetit të qytetarëve, për ç'arsye janë zhvilluar aksione të vazhdueshme në terren për largim të mallrave ushqimore të cilësuar si të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve.

**INSPEKTORI I NDËRTIMIT**

*Gjatë periudhës janar-qershor, inspektorët e ndërtimit kanë kryer:*

| Inspektime | Aktvendime | Njoftime | Fletëparaqitje | Gjoba mandatore |
|------------|------------|----------|----------------|-----------------|
| 107        | 57         | 13       | 3              | 2               |

Në këtë periudhë raportuese ne kemi qenë vazhdimisht në vëzhgim të terrenit, gjatë kontrollimeve kemi verifikuar objektet të cilat nuk posedojnë leje ndërtimi dhe janë marrur masat paraprake të parapara me ligjet e ndërtimit dhe rregulloret në fuqi, si dhe kemi bërë rrënimin e objekteve të karakterit afarist - auto larje në fshatin Krushe e Madhe.

**INSPEKTORI SANITAR**

*Gjatë periudhës janar-qershor, inspektori sanitar ka kryer:*

| Inspektime | Pëlqime sanitare | Aktvendime | Fletëparaqitje |
|------------|------------------|------------|----------------|
| 205        | 4                | 32         | 8              |

Në fushën e gastronomisë bazuar në raportet nga terreni, gjendja e përgjithshme higjieno- sanitare e restoranteve, gjelltove, fast- foodeve të ndryshëm në komunën e Rahovecit është në nivelin mesatar, me IKSHPK-në kemi pasur bashkëpunim të vazhdueshëm në lëminë e sanitarisë.

Pas shfaqjes së Pandemisë COVID-19, kemi bërë të mundur përcjelljen e kushteve të transportit dhe varrimit të të vdekurve nga COVID-19.

#### INSPEKTORI VETERINAR

*Gjatë periudhës janar-qershor, inspektori veterinar ka kryer:*

| Inspektime | Asgjësime                                          |
|------------|----------------------------------------------------|
| 164        | 14 kg mish me vlerë 59.50 euro me afat të skaduar. |

Gjatë kësaj periudhe raportuese në vazhdimësi kemi bërë kontrollimin e mishtove dhe therrtove, ku prodhuesit e mishit i kemi urdhëruar që të pajisin të gjithë punëtorët me librezë sanitare. Në fshatin Hoçë e Madhe me ordinancën veterinarë janë kapur 4 qenë endacakë.

#### INSPEKTORI I KOMUNIKACIONIT

*Gjatë periudhës janar-qershor, inspektori i komunikacionit ka kryer:*

| Inspektime | Urdhëresa |
|------------|-----------|
| 119        | 2         |

Në fushën e transportit publik, në vazhdimësi kemi përcjellë nga afër punën e kompanive të licencuara të autobusëve, të cilat janë duke i mbuluar mjaftueshëm dhe sigurt linjat e transportit të udhëtarëve, në kuadër të përgjegjësisë tona për sinjalizim horizontal dhe vertikal të rrugëve në vazhdimësi jemi munduar që mjaftueshëm të mbulojmë të gjitha rrugët në qytet dhe shumicën e rrugëve nëpër fshatra me sinjalizimin e nevojshëm.

#### INSPEKTORI I BUJQËSISË

*Gjatë periudhës janar-qershor, inspektori i bujqësisë ka kryer:*

| Inspektime | Aktvendime | Fletëparaqitje |
|------------|------------|----------------|
| 73         | 2          | 2              |

Gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar inspektimi për ruajtjen e tokës bujqësore nga degradimet joligjore dhe inspektimi i barnatoreve veterinarë dhe bujqësore.

### INSPEKTORI I PYLLTARISË DHE MBROJTJES SË AMBINETIT

*Gjatë periudhës janar-mars, inspektori i pylltarisë dhe mbrojtjes së ambientit ka kryer:*

| Inspektime | Fletëparaqitje | Gjoha mandatore |
|------------|----------------|-----------------|
| 92         | 2              | 2               |

Në gjashtëmujin e parë të vitit 2020 kemi shpeshtuar inspektimet për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së përgjithshme për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit dhe ndëshkimin e të gjithë atyre që qëllimshëm e dëmtojnë mjedisin dhe hapësirat publike.

### INSPEKTORI I ÇËSHTJEVE KOMUNALE

*Gjatë periudhës janar-qershor, inspektori i çështjeve komunale ka kryer:*

| Inspektime | Aktvendime |
|------------|------------|
| 135        | 64         |

Angazhimi maksimal nuk ka munguar edhe në kontrollin e shfrytëzimit të të gjitha sipërfaqeve publike në territorin e Komunës së Rahovecit, ku nga ana e inspektorit të çështjeve komunale është bërë mbikëqyrja e kyçjeve në sistemin e rrjetit të ujësjellësit publik nga personat fizikë dhe juridik, mënyra e shfrytëzimit dhe keqpërdorimet eventuale të ujit të pijshëm, mbikëqyrja e ndërhyrjeve eventuale mbi infrastrukturën rrugore.

*Drejtoria për Punë Inspektuese pas shpalljes së gjendjes emergjente nga Qeveria e Republikës së Kosovës si pasojë e pandemisë COVID-19 i ka zbatuar këto urdhëresa si dhe vendimet e Kryetarit z.Smajl Latifi:*

- Sipas vendimit të qeverisë, janë mbyllur të gjitha kafiteritë, baret dhe restaurantet, me përjashtim të farmacive dhe marketve ushqimore;
- Janë krijuar komisione për inspektimin e të gjitha bizneseve, qendrave tregtare, barnatoreve për mundësinë e manipulimit (ngritjes) së çmimeve të produkteve;
- Në vijim të masave për të parandaluar përhapjen e COVID-19, për të shuar çdo mundësi përhapjeje të këtij virusi, janë mbyllur tregjet në këto vendbanime: Rahovec, Krushë e Madhe dhe Ratkoc;
- Për shkak të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe shumë të lartë që secili prej nesh të infektohet me COVID-19, për të parandaluar frekuentimin e pakontrolluar, në vende rekreative të hapura si: Maja e Shkodranit, Ura e Fshajtë etj, Shtabi i Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit ka marrë këtë VENDIM: Ndalohen lëvizjet në grupe dhe grumbullimet e qytetarëve, në këto zona;
- Inspektorët komunal po i vazhdojnë inspektimet 24 orë në terren, dhe janë duke e kryer punën në mënyrë të organizuar, është bërë edhe lirimi i trotuareve nga mallrat, poashtu, furrat që shërbejnë në komunën e Rahovecit janë të obliguar që bukën ta mbështjellin me material mbrojtës.

**DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM**

- Gjatë këtyre gjashtë muajve drejtori i DMSH-së ka qenë i angazhuar në menaxhim të kontratës për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, së bashku me kompanitë e kontraktuara nga komuna kanë qenë tërë kohën në terren, në çdo vendbanim të gjitha rrugët primare dhe sekondare janë pastruar me kohë dhe nuk është krijuar ndonjë problem në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe këmbësorve;
- Në sektorin e zjarrfiksave në këtë gjashtëmuor janë gjithsej 92 raste që kanë pasur nevojë për intervenim, pothuajse të gjitha rastet kanë qenë intervenime të lehta, vetëm një numër i vogël i tyre ishin intervenime të natyrës pak më të rëndë por që fatmirësisht nuk ka pasur viktima por vetëm ka pasur dëme material;
- Angazhim të rregullt në KKSB( Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi);
- Janë inspektuar lumenjtë, përrenjtë dhe kanalet e hapura dhe pas incizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse për trajtim të kanaleve të bllokuara, pastrim të përrenjve etj;
- Është bërë servisimi i të gjitha aparateve për shuarjen e zjarreve;
- Me ngritjen e Shtabit Emergjent të Komunës me vendim të Kryetarit, në njësinë e zjarrfikjes është bërë mobilizim i brendshëm dhe është ngritur niveli i gatishmërisë;
- Përmes drejtorisë së shëndetësisë është bërë dezinfektimi i të gjitha hapësirave në ndërtesën e zjarrfikësve, poashtu edhe dezinfektimi i kamionave dhe pajisjeve për intervenim;
